



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 629 Akti

Nr. 718 Vendimi
Tiranë, më 24.11.2023

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Lulzim Hamitaj Kryesues
Brunilda Bektashi Relatore
Etleda Çiftja Anëtare

asistuar nga sekretarja gjyqësore, znj. Albana Plaka, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Francesco Ciardi, në datën 21.11.2023, ora 12:00, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, mori në shqyrtim në seancën dëgjimore publike çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Znj. Gilda Hoxha¹**, me detyrë gjyqtare në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër.

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Neni 179/b, paragrafi 5, neni Ç, paragrafi 1 dhe nenet D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998”;

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, e ndryshuar;

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, komisioneren Brunilda Bektashi, mori në shqyrtim dhe analizoi provat shkresore të paraqitura nga subjekti i

¹ Gilda Hoxha ka marrë titullin “Jurist” nga Universiteti i Tiranës në datën 30.6.2006 dhe titullin “Magjistrat gjyqtar” nga Shkolla e Magjistraturës në vitin 2011. Subjekti i rivlerësimit në tetor 2009 deri në nëntor 2011 ka ndjekur studimet në Shkollën e Magjistraturës; nëntor 2011 deri në nëntor 2012 ka kryer stazhin në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë dhe më tej ka qenë në pritje të emërimit. Nga janari 2014 dhe deri në deklaraten *Vetting*, subjekti i rivlerësimit ushtron funksionin e gjyqtarit në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër. Gjyqtarja është bërë subjekt rivlerësimi prej vitit 2011.

rivlerësimit, për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit kryesisht, si dhe shqyrtoi dhe analizoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I. FAKTET DHE RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Subjekti i rivlerësimit, znj. Gilda Hoxha, me detyrë gjyqtare në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër, referuar pikës 3 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i është nënshtruar rivlerësimit *ex officio* nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim Komisioni).

2. Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në Komision janë administruar raportet e hartuara nga institucionet: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI); Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (AKSIK), ish-DSIK; Këshilli i Lartë Gjyqësor (KLGJ).

3. Bazuar në pikën 2 të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016 dhe në rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit”, Komisioni ka zhvilluar shortin në datën 15.6.2020, në përfundim të të cilit rezultoi që subjekti i rivlerësimit Gilda Hoxha do t’i nënshtrohej procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues i përbërë nga komisionerët Lulzim Hamitaj, Brunilda Bekteshi dhe Etleda Çiftja. Relatore e çështjes u zgjodh me short komisionere Brunilda Bekteshi.

4. Komisioni, me vendimin nr. 1, datë 21.12.2020, të trupit gjykues, vendosi të fillojë hetimin administrativ sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit të subjektit Gilda Hoxha, si dhe caktoi kryesues të trupit gjykues komisionerin Lulzim Hamitaj. Anëtarët e trupit gjykues deklaruan se nuk ishin në kushtet e konfliktit të interesit me subjektin e rivlerësimit.

5. Subjektit iu komunikua në rrugë elektronike përbërja e trupit gjykues, duke iu bërë me dije e drejta për t’u shprehur në lidhje me konfliktin e interesit. Subjekti i rivlerësimit, sipas kërkesës së Komisionit, në datën 12.1.2021, ka deklaruar mungesën e konfliktit të interesit me anëtarët e trupit gjykues.

6. Në datën 9.11.2023, Komisioni, me vendimin nr. 2, vendosi: (i) të përfundojë hetimin administrativ kryesisht për subjektin e rivlerësimit Gilda Hoxha për të tria kriteret e rivlerësimit: vlerësimi i pasurisë, kontrolli i figurës dhe vlerësimi i aftësive profesionale, bazuar në rezultatet e hetimit të paraqitura nga relatorja e çështjes; (ii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit mbi rezultatet e hetimit kryesisht dhe të paraqesë pretendimet e saj brenda datës 16.11.2023 nga marrja e njoftimit me postë elektronike, për t’u njohur me provat e administruara nga Komisioni në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016, si dhe nenet 35 - 40 dhe 45 - 47 të Kodit të Procedurave Administrative.

7. Në datën 9.11.2023, subjekti i rivlerësimit u njoftua lidhur me: (i) rezultatet e hetimit kryesisht; (ii) kalimin e barrës së provës sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016; (iii) të sjellë prova për të provuar të kundërtën, brenda 7 ditëve. Në datën 13.11.2023, subjekti u njoh dhe u pajis me kopje të dokumentacionit të dosjes. Në datën 16.11.2023, subjekti dërgoi në rrugë elektronike shpjegimet dhe provat mbi rezultatet e hetimit administrativ.

8. Trupi gjykues, në datën 17.11.2023, me vendimin nr. 3, vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit Gilda Hoxha në seancë dëgjimore, në përputhje me nenin 55 të ligjit nr. 84/2016. Në datën 17.11.2023, subjekti i rivlerësimit u njoftua se seanca dëgjimore do të zhvillohej më 21.11.2023, në orën 12:00, në Pallatin e Koncerteve, Tiranë.

II. SEANCA DËGJIMORE

9. Seanca dëgjimore me subjektin e rivlerësimit Gilda Hoxha u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Francesco Ciardi. Gjatë seancës dëgjimore subjekti i rivlerësimit shprehu qëndrimin lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht, si dhe me procesin e rivlerësimit të kryer nga Komisioni. Në përfundim të parashtrimeve, subjekti i rivlerësimit kërkoi konfirmimin në detyrë.

10. Në përfundim të seancës dëgjimore, bazuar në pikën 2 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues vendosi të përfundojë procesin e rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit Gilda Hoxha. Trupi gjykues ndërpreu seancën dëgjimore të datës 21.11.2023, për të rifilluar më 24.11.2023 për shpalljen e vendimit.

III. QËNDRIMI DHE MENDIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

11. Znj. Gilda Hoxha ka qenë bashkëpunuese në procesin e rivlerësimit, duke u përgjigjur kur është kërkuar sipas afatit të përcaktuar, sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, gjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ të zhvilluar ndaj saj.

IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI ADMINISTRATIV I KRYER NGA KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

12. Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni, është një proces kushtetues, i cili mbështetet në nenin 179/b dhe në Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” sipas kërësive IV, V dhe VI të këtij ligji. ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të paraqitur një raport me konstatime në lidhje me vlerësimin pasuror. Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, duke paraqitur në Komision një raport me konstatimin në lidhje me përshtatshmërinë apo papërshtatshmërinë e subjektit të rivlerësimit. KLGJ-ja është organi ndihmës i ngarkuar me ligj për të paraqitur një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar në lidhje me vlerësimin profesional. Referuar vendimit nr. 2/2017 të Gjykatës Kushtetuese² dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues Komisioni realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, i cili nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

A. VLERËSIMI I PASURISË

A/1. Vlerësimi i pasurisë nga ILDKPKI-ja

13. ILDKPKI-ja, në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, ka dërguar raportin e hollësishëm dhe të arsyetuar nr. *** prot., datë 28.1.2019, pas procedurës së kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit Gilda Hoxha, në zbatim të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, si dhe të ligjit nr. 9367, datë 10.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, ku më

² Gjykata vlerëson se pretendimi se organet ekzistuese zëvendësojnë organet e reja të rivlerësimit është i pabazuar. Sipas pikës 5 të nenit 179/b të Kushtetutës, rivlerësimi kryhet nga Komisioni, kurse sipas nenit 4/2 të ligjit nr. 84/2016: “Komisioni dhe Kolegji i Posaçëm i Apelit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit”. Pavarësisht formulimit të kësaj dispozite, ajo nuk mund të lexohet në mënyrë të shkëputur, por në harmoni me dispozitat e tjera ligjore që përcaktojnë në mënyrë të detajuar kompetencat e organeve të përfshira në proces, si dhe kompetencat që kryen Komisioni gjatë këtij procesi. Në nenin 5/1 të ligjit nr. 84/2016 parashikohet se: “Procesi i rivlerësimit të subjekteve të rivlerësimit kryhet nga Komisioni, Kolegji i Posaçëm i Apelit, Komisioneri Publik, në bashkëpunim me vëzhguesit ndërkombëtarë”. Po ashtu, siç u përmend edhe më sipër, bazuar në dispozitat e kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezultojnë se: “Në kryerjen e funksionit të tyre kushtetues, organet e rivlerësimit kryejnë një proces të mirëfilltë kontrolli dhe vlerësimi dhe nuk bazohen dhe as janë të detyruara nga përfundimet e paraqitura atyre nga organet e tjera ndihmëse”.

parë subjekti, në datën 27.1.2017, referuar ligjit nr. 84/2016, ka dorëzuar deklaratën e pasurisë së rivlerësimit kalimtar *Vetting*. Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera nga ILDKPKI-ja, në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, si për subjektin e rivlerësimit, ashtu edhe për personat e lidhur me të, për vlerësimin e pasurisë ky institucion ka konstatuar se:

- deklarimi është i saktë dhe në përputhje me ligjin;
- ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;
- nuk ka kryer fshehje të pasurisë;
- nuk ka kryer deklarim të rremë;
- subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

A/2. Rivlerësimi i pasurisë nga Komisioni

14. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë: (a) provat e dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI në deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar *Vetting*; (b) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja; (c) deklaratimet dhe provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, të bëra me anë të komunikimit elektronik; (ç) shpjegimet me shkrim dhe dokumentacionin mbështetës të paraqitur nga subjekti i rivlerësimit pas mbylljes së hetimit administrativ; (d) shpjegimet e dhëna në seancë dëgjimore për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

15. Komisioni hetoi në mënyrë të pavarur çdo informacion dhe konkluzion të ILDKPKI-së, ashtu sikurse të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me ligjin nr. 84/2016, hetim i cili konsistoi në: (i) verifikimin e vërtetësisë së deklarimeve në lidhje me gjendjen pasurore të subjektit dhe të personave të lidhur; (ii) verifikimin e burimeve të krijimit të të ardhurave dhe të shpenzimeve, me qëllim evidentimin e mungesës së mundshme të burimeve të mjaftueshme financiare për të justifikuar pasuritë; (iii) evidentimin e ndonjë fshehjeje të mundshme të sendeve në pronësi ose në përdorim; (iv) evidentimin e ekzistencës së mundshme të deklarimeve të rreme apo të ndonjë konflikti të interesave, të parashikuar nga pika 5 e nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

16. Mbi pasuritë e deklaruara në deklaratën *Vetting* sipas formularit (shtojca nr. 2), datë 27.1.2017, nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, në zbatim të ligjit nr. 84/2016, nga hetimi rezultoi se subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti i saj kanë deklaruar në deklaratën *Vetting* pasuritë si vijon:

17. Apartament në përdorim me sip. 117.26 m², me adresë Q, rruga “****”, Njësia Administrative D, Tiranë. Apartamenti është në pronësi të bashkëshortit dhe është fituar prej tij para martesës dhe para fillimit të detyrës, sipas kontratës nr. *** rep., nr. *** kol., datë 16.5.2009, të noteres M.SH. Vlera: 53.630 euro. Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës disa dokumente³.

17.1 ILDKPKI-ja në raportin e saj është shprehur: *Konfirmohet deklarimi me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjen e ardhur nga DPPPP-ja.*

Hetimi i Komisionit

17.2 Nga hetimi rezultoi se në deklaratën e interesave privatë para fillimit të detyrës të vitit 2011, bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ka deklaruar: *“Apartament 120 m², adresa Komuna D, Tiranë. Burim krijimi: kursime nga puna dhe ndihmë nga prindërit dhe të afërm. Vlera: 53.000 euro. Pjesa takuese: 100%”*.

³ Kontratë nr. *** rep., nr. *** kol., datë 16.5.2009, mes shoqërisë “B****” sh.p.k. dhe shtetasit E.H, për blerje apartamenti me sip. 117.26 m², Komuna D, Tiranë, vlera 53.630 euro, likuiduar vlera 47.000 euro me nënshkrimin e kontratës, 6.630 euro në momentin e dorëzimit të apartamentit; akt martese nr. ***, datë 31.3.2011, midis shtetasve E.H dhe Gilda Ll (aneks nr. 4/2 në dosjen e ILDKPKI-së).

17.3 Komisioni e ka trajtuar këtë pasuri në deklarin e pasurive të bashkëshortit të subjektit në vijim në këtë vendimmarrje, duke qenë se është një pasuri në pjesë takuese 100% të bashkëshortit, e krijuar përpara martesë dhe përpara emërimit në detyrë të subjektit të rivlerësimit.

18. Gjendje e llogarisë së pagës në datën 20.1.2017, në shumën 6.692 lekë. Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratën nxjerrjen e llogarisë nga Raiffeisen Bank⁴, datë 20.1.2017, për znj. Gilda Hoxha, me gjendje në datën 20.1.2017, në vlerën 6.692 lekë.

18.1 ILDKPKI-ja në raportin e saj është shprehur: *Konfirmohet deklarimi me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjen e ardhur nga Raiffeisen Bank.*

18.2 Raiffeisen Bank⁵ informon se znj. Gilda Hoxha ka llogari page pranë kësaj banke. Gjendja e llogarisë në datën 29.1.2017, kur është depozituar deklarata *Vetting*, është 6.567,48 lekë. Trupi gjykues konstaton se diferenca në vlerën e deklaruar vjen për shkak të komisionit mujor të mbajtur prej bankës.

DETYRIME FINANCIARE

19. Kredi për blerje apartament banimi (dorëzanëse), në datën 12.6.2012, në shumën 1.985.700 lekë, me 3% në vit, me afat 20 vjet. Kësti mujor: 11.046 lekë. Fillon në datën 12.6.2012 dhe përfundon në datën 12.6.2032. Gjendja e detyrimit në datën 19.1.2017, në shumën 1.629.675,31 lekë.

Kredi (e bashkëshortit E.H) për blerje apartament banimi (kredimarrës), në datën 12.6.2012, në shumën 1.985.700 lekë, me 3% në vit, me afat 20 vjet. Kësti mujor: 11.046 lekë. Fillon në datën 12.6.2012 dhe përfundon në datën 12.6.2032. Gjendja e detyrimit në datën 19.1.2017, në shumën 1.629.675,31 lekë. Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës disa dokumente⁶.

19.1 ILDKPKI-ja në raportin e saj është shprehur: *Konfirmohet deklarimi me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjet e ardhura nga BKT-ja dhe DPPP-ja.*

Hetimi i Komisionit

19.2 Subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti i saj e kanë deklaruar këtë kredi në deklaratën periodike vjetore të vitit 2012, në rubrikën e detyrimeve financiare, me përshkrimin “Kredi për blerje apartament banimi, në datën 12.6.2012, në shumën 1.985.700 lekë, me 3% në vit, me afat 20 vjet, me këst mujor 11.000 lekë/muaj. Fillon më 12.6.2012 dhe përfundon më 12.6.2032”.

19.3 Nga korrespondenca e Komisionit me BKT-në⁷ konfirmohet kredia e marrë në datën 12.6.2012, në vlerën 1.985.700 lekë. Së bashku me informacionin e dhënë, BKT-ja ka përcjellë kontratën e kredisë dhe atë të hipotekimit.

19.4 Nga analizimi i *statement*-it konfirmohet detyrimi i mbetur deri më 29.1.2017, i cili është në vlerën 1.629.675,31 lekë.

⁴ Aneks nr. 4/3 në dosjen e ILDKPKI-së.

⁵ Me shkresën nr. *** prot., datë 16.3.2021.

⁶ Kontratë kredie nr. *** rep., nr. *** kol., datë 12.6.2012, me palë kredidhënëse BKT, palë kredimarrëse E.H, dorëzanës Gilda Hoxha, J.LL e A.LL, vlera 1.985.700 lekë; qëllimi i kredisë për likuidimin e vlerës së mbetur të çmimit të blerjes së apartamentit dhe shuma do të transferohet në favor të shitësit të objektit te shoqëria “A. K” sh.p.k.; vërtetim nr. *** prot., datë 19.1.2017, nga BKT, me të cilin vërtetohet se shtetasi E.H ka përfutuar kredi pranë kësaj banke në shumën 1.985.700 lekë, sipas kontratës së kredisë nr. *** rep., nr. *** kol., datë 12.6.2012, afati 240 muaj, vlera e mbetur e kredisë 1.629.675 lekë; kontratë prentim apartamenti nr. *** kol., nr. *** rep., datë 9.3.2012, me palë sipërmarrëse shoqëria “A. K” sh.p.k. dhe palë porositëse E.H për porositje apartamenti me sip. 79.85 m², lagjja “****”, Vlorë, vlera 4.500.000 lekë, ku kësti i parë prej 2.500.000 lekësh është likuiduar në janar të vitit 2012, kësti i dytë prej 2.000.000 lekësh do të likuidohet deri në prill të vitit 2012; revokim kontrate nr. *** rep., nr. *** kol., datë 3.7.2012, ku shoqëria “A. K” sh.p.k. dhe shtetasi E.H revokojnë kontratën për prentim apartamenti nr. *** rep., nr. *** kol., datë 9.3.2012, blerësit i është kthyer shuma e paguar jashtë zyrës noteriale (aneks nr. 4/5 në dosjen e ILDKPKI-së).

⁷ Me shkresën nr. *** prot., datë 23.3.2021.

19.5 Komisioni konstaton se përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjen e ardhur nga BKT-ja për vlerën e mbetur të kësaj kredie deri në datën e dorëzimit të deklaratës *Vetting*.

Deklarimi i pasurive të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit

20. Apartament banimi me sip. 117.26 m², me adresë Q, rruga “****”, Tiranë. Apartamenti është blerë sipas kontratës nr. *** rep., nr. *** kol., datë 16.5.2009, të noteres M.SH, me vlerë 53.630 euro. Burimi i krijimit: ndihmë nga prindërit dhe të afërm, si dhe kursime nga puna. Pjesa takuese: 100%. Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës disa dokumente⁸.

20.1 ILDKPKI-ja në raportin e saj është shprehur: *Konfirmohet deklarimi me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjen e ardhur nga DPPPP-ja.*

Hetimi i Komisionit

20.2 Nga hetimi i kryer rezultoi se në deklaratën e interesave privatë para fillimit të detyrës të vitit 2011, bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ka deklaruar: *“Apartament 120 m², adresa Komuna D, Tiranë. Burimi i krijimit: kursime nga puna dhe ndihmë nga prindërit dhe të afërm. Vlera: 53.000 euro. Pjesa takuese: 100%”*.

20.3 Subjekti së bashku me deklaratën *Vetting* ka depozituar kontratën nr. *** rep., nr. *** kol., datë 16.5.2009, lidhur mes shoqërisë “B****” sh.p.k. dhe z. E.H (bashkëshorti i subjektit), për blerje apartamenti me sip. 117.26 m², Komuna D, Tiranë, me vlerë 53.630 euro.

20.4 Nga korrespondenca e Komisionit me ASHK-në⁹, nuk konfirmohet regjistrimi i pasurisë apartament në emrin e bashkëshortit të subjektit.

20.4.i Komisioni e ka pyetur¹⁰ subjektin lidhur me regjistrimin e kësaj pasurie, si dhe i ka kërkuar të depozitojë dokumentacion justifikues. Subjekti në përgjigje ka sqaruar se *shoqëria e ndërtimit nuk e respektoi lejen e ndërtimit dhe nuk e regjistroi pallatin në ZRPP. Për këtë arsye, regjistrimi i apartamentit u krye nëpërmjet procedurës së legalizimit sipas lejes për legalizim me nr. ***, datë 31.5.2022. Certifikata e kësaj pasurie të paluajtshme akoma nuk është lëshuar nga ASHK.*

20.4.ii Në mbështetje të deklaramit, subjekti ka depozituar vendimin nr. ***, datë 31.5.2022, për legalizimin e ndërtimit pa leje. Nga verifikimi përkatës, Komisionit i rezultoi se në këtë vendim identifikohet pasuria apartament sipas kontratës nr. *** rep., nr. *** kol., datë 16.5.2009, lidhur midis sipërmarrësit, shoqëria “B****” sh.p.k. dhe porositësit E.H (bashkëshorti i subjektit), për të cilën është vendosur legalizimi i këtij apartamenti.

20.5 FSHU-ja¹¹ informon se me gjeneralitetet E.H, referuar sistemit të faturimit, identifikohen dy abonentë me kontratë të furnizimit të energjisë elektrike, përkatësisht kontrata nr. *** dhe nr. ***, në instancën Tiranë.

⁸ Kontratë nr. *** rep., nr. *** kol., datë 16.5.2009, me palë sipërmarrëse/investitore shoqëria “B****” sh.p.k. dhe palë blerëse E.H, për blerje apartamenti me sip. 117.26 m², Komuna D, Tiranë, vlera 53.630 euro, likuiduar vlera 47.000 euro me nënshkrimin e kontratës, 6.630 euro në momentin e dorëzimit të apartamentit (aneks nr. 4/2 në dosjen e ILDKPKI-së); kontratë shitblerjeje nr. ***, datë 5.6.1996, me palë shitëse E. e V.H dhe palë blerëse firma “Gj.”, për shitje shtëpi banimi, lagja “****”, rruga “****”, vlera 25.000 USD (aneks nr. 4/6 në dosjen e ILDKPKI-së); kontratë shitjeje nr. *** rep., nr.*** kol., datë 8.8.2010, me palë shitëse E, V, E dhe B.H dhe palë blerëse E, E dhe F.M, për shitje të 4 tokave pemëtoare në R, vlera totale 2.000.000 lekë (aneks nr. 4/6 në dosjen e ILDKPKI-së); kontratë shitjeje datë 18.10.2000, me palë shitëse E.H dhe palë blerëse G.N, për shitje objekti “ish-salla e mbledhjeve J”, me sip. 236 m², vlera 1.800.000 lekë + praktika e blerjes së saj nga AKP Vlorë (aneks nr. 4/6 në dosjen e ILDKPKI-së); deklaratë noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 19.9.2014, me deklarues A.H e E.H, ku A.H deklaron se në cilësinë e pronarit të truallit në lagjen “****”, Vlorë, ka përfitur nga ndërtimet e bëra mbi këtë truall apartamente banimi. Vlerën e një apartamenti që ia ka shitur shtetasit A.P nëpërmjet kontratës nr. *** rep., nr. *** kol., datë 23.8.2006, në shumën 43.000 euro, ia ka dhënë nipit të tij E.H në janar të vitit 2009 për nevojat e tij. Shuma është dhënë pa shkresë në kushtet që deklaruesit janë në marrëdhënie të posaçme (aneks nr. 4/9 në dosjen e ILDKPKI-së).

⁹ Shkresë e Komisionit nr. *** prot., datë 4.3.2021, drejtuar ASHK-së.

¹⁰ Me pyetësorin nr. 2, datë 13.9.2023, administruar në dosjen e Komisionit.

¹¹ Me shkresën nr. *** prot., datë 15.4.2021.

20.5.i Kontrata nr.*** korrespondon me pasurinë apartament objekt vlerësimi.

20.5.ii Ndërsa lidhur me kontratën tjetër, Komisioni i ka kërkuar¹² shpjegime subjektit, e cila në përgjigje ka sqaruar se *bashkëshorti është titullar vetëm i kontratës së energjisë elektrike me nr. ***. Me shkresën nr. *** prot., datë 11.10.2023, nga Furnizuesi i Shërbimit Universal sh.a. provohet se referuar sistemit të faturimit kontrata nr. ***, me kod klienti ***, nuk i përket abonentit E.H, me ID *** (ID-ja e bashkëshortit E. V. H), por i përket një abonenti tjetër me ID tjetër.*

20.5.iii Në mbështetje të deklaramit, subjekti ka bashkëlidhur shkresën nr. *** prot., datë 11.10.2023, lëshuar nga Furnizuesi i Shërbimit Universal sh.a. (OSHEE Group), ku konfirmohet ky fakt.

20.6 UKT-ja¹³ informon se nuk rezulton asnjë e dhënë për kontrata për shërbime Ujësjellës-Kanalizime Tiranë sh.a., të regjistruara në sistem në emër të tyre.

20.6.i Subjektit të rivlerësimit i është kërkuar¹⁴ të depozitohet librezën e furnizimit me ujë të pijshëm për këtë pasuri, e cila ka depozituar librezën përkatëse, që konfirmon pagesat me këtë operator që i përket kontratës së furnizimit me ujë të pijshëm të bashkëshortit me nr. ***, për apartamentin në qytetin e Tiranës.

20.7 Lidhur me burimin e krijimit të pasurisë apartament

20.7.1 Subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti i saj kanë deklaruar në deklaratën *Vetting* se burim krijimi për këtë pasuri kanë shërbyer ndihma nga prindërit dhe të afërm, si dhe kursime nga puna.

20.7.2 Komisioni i ka kërkuar¹⁵ subjektit të depozitohet dokumentacion justifikues ligjor, si dhe të specifikojë kontributin në vlerë monetare për secilin burim. Subjekti në përgjigje ka sqaruar: *“...pjesa më e madhe e kontributit për blerjen e apartamentit ka burim krijimi ndihmë nga prindërit, të ardhurat dhe kursimet e tyre ndër vite. Konkretisht rezulton se nëna e bashkëshortit E.H ka qenë pronare e pasurisë të ndodhur në zonën kadastrale *** (objekt ish-salla e mbledhjeve nr. ***, me sipërfaqe 236 m², si dhe e truallit me sipërfaqe 236 m²). Kjo pasuri ka shërbyer për disa vite si bar-restorant (subjekti “J”). Në datën 18.10.2000, me kontratën nr. ***, kjo pasuri është shitur në vlerën 1.800.000 (një milion e tetëqind mijë) lekë. Me kontratën nr. *** noterie, datë 5.6.1996 prindërit e bashkëshortit kanë shitur një shtëpi banimi në vlerën 25.000 (njëzet e pesë) mijë dollarë. Gjithashtu, prindërit e bashkëshortit kanë shitur si bashkëpronar së bashku me bashkëshortin një pasuri të llojit pemëtore, kundrejt vlerës 2.000.000 (dy milionë) lekë, provuar me kontratën nr. *** rep., nr. *** kol., datë 8.8.2010”. Sa i përket kursimeve të bashkëshortit, subjekti ka deklaruar se ky i fundit që prej vitit 2005 deri në vitin 2011 (deklarimi fillestar) rezulton se ka punuar pedagog në universitetin “I.Q”, inspektor rajonal në KQZ, drejtor juridik pranë Komunës Q, si dhe drejtor i marrëdhënieve me publikun pranë Bashkisë V. Bashkëshorti ka marrë dhuratë nga xhaxhai i tij A.H shumën 43.000 euro, në muajin janar 2009, shumë me të cilën mendonte të zhvillonte një aktivitet privat. Subjekti ka depozituar deklaratën noteriale nr. ***, datë 21.9.2023, nga verifikimi i së cilës konstatohet se shtetasi A.H deklaron: “Sikurse kam deklaruar në deklaratën noteriale nr. ***, datë 19.9.2014, në janar të vitit 2009 i kam dhuruar nipit tim E.V.H shumën 43.000 euro. Unë dhe vëllai im V.H kemi ushtruar aktivitet tregtar të përbashkët në subjektin “J”. Pas mbylljes së këtij aktiviteti unë kam zhvilluar në mënyrë të suksesshme aktivitete të ndryshme ekonomike, të cilat ndër vite më kanë siguruar të ardhura shumë të mira, të cilat i kam investuar edhe në blerje pasurie të paluajtshme të llojit truall. Në vitin 2009, të ardhurat e siguruar nga shitja e një apartamenti shtetasit A.P, sipas kontratës së sipërmarrjes datë 23.8.2006,*

¹² Pyetësor nr. 4, datë 9.10.2023, administruar në dosjen e Komisionit.

¹³ Me shkresën nr. *** prot., datë 30.3.2021.

¹⁴ Pyetësor nr. 4, datë 9.10.2023, administruar në dosjen e Komisionit.

¹⁵ Me pyetësorin nr. 2, datë 13.9.2023, administruar në dosjen e Komisionit.

*apartament të fituar sipas kontratës së sipërmarrjes datë 22.8.2006, nr. ***rep., nr. *** kol. (notere D.A, Vlorë), ia kam dhuruar nipit tim (djalin të vëllait tim V.H). Këtë shumë e kam konsideruar edhe si kompensim të ndihmës që vëllai dhe nipi im më kanë dhënë gjatë viteve për zhvillimin e bizneseve të mija. Në momentin e lidhjes së kontratës prindërit ishin kontribuues për të paguar vlerën e apartamentit të porositur dhe nga shuma e dhuruar nga xhaxhai, bashkëshorti ka përdorur rreth 8.000 euro...”.*

20.7.3 Komisioni analizoi secilin burim krijimi, si më poshtë detajuar:

20.7.3.i Lidhur me të ardhurat e përfituara nga punësimi i prindërve të bashkëshortit, subjekti ka depozituar dosjen e pensionit nga ISSH Drejtoria Rajonale Vlorë, për shtetasit E.H dhe V.H. Komisioni verifikoi dokumentacionin e depozituar dhe konstatoi se prindërit e bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit kanë qenë të punësuar në institucione shtetërore. Komisioni përlllogarit të ardhurat neto sipas legjislacionit të kohës për periudhën 1994 – 2009 dhe i rezultoi se nga prindërit është përfitur shuma 7.497.632 lekë.

Komisioni, në lidhje me babain e bashkëshortit të subjektit, z. V.H, për periudhën 2007 – 2009, u bazua në shumën totale të kredituar në llogarinë e tij bankare në BKT.

20.7.3.ii Lidhur me të ardhurat e përfituara nga punësimi për bashkëshortin e saj, subjekti ka depozituar: vërtetim nr.*** prot., datë 5.1.2017, nga KQZ; vërtetim datë 20.1.2017 nga universiteti “I. Q” Vlorë; vërtetim nr. ***, datë 4.11.2017, nga Bashkia VI. Komisioni përlllogarit të ardhurat e përfituara nga punësimi për periudhën 2006 – 2009, duke u bazuar në shumën totale të kredituar në llogarinë bankare në Raiffeisen Bank dhe i rezultoi se është përfitur shuma 1.453.079 lekë.

20.7.3.iii Lidhur me të ardhurat e përfituara nga shitja e pasurive të paluajtshme, subjekti ka depozituar kontratat e shitblerjeve, përkatësisht: kontratë shitjeje nr. *** noterie, datë 5.6.1996, për shitjen e shtëpisë së banimit, e cila është hipotekuar në regjistrin e transkriptimeve të hipotekës nr. ***, datë 6.10.1994, në vlerën 25.000 USD; kontratë shitblerjeje nr. *** noterie, datë 18.10.2000; vërtetim hipotekor për shitjen e objektit në vlerën 1.800.000 lekë.

Gjithashtu, për pasuritë e shitura, subjekti ka depozituar¹⁶ vërtetim pronësie dhe certifikatë pronësie për të provuar kalimin e pronësisë në emër të blerësve.

20.7.3.iv Lidhur me të ardhurat e përfituara nga të afërm, subjekti ka depozituar: (a) deklaratë noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 19.9.2014, në të cilën shtetasi A.H (xhaxhai i bashkëshortit) deklaroi se i ka dhënë nipit të tij E.H në janar të vitit 2009 shumën 43.000 euro, të përfitur nga shitja e një pasurie të paluajtshme. Bashkëlidhur deklaratës noteriale subjekti ka depozituar kontratën e sipërmarrjes datë 23.8.2006, lidhur ndërmjet shtetasve A.H në cilësinë e pronarit të truallit dhe A.P në cilësinë e porositësit për shitjen e pasurisë apartament në vlerën 43.600 euro; (b) kontratë sipërmarrjeje pronar truall - investitor nr. *** rep., nr. *** kol., datë 22.9.2005, lidhur mes palëve, pronarë truall - shtetasit A.R dhe A.H dhe investitor shoqëria “A. I. K” sh.p.k.; (c) aneks kontratë sipërmarrjeje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 8.4.2013, në të cilën janë përcaktuar fizikisht pjesët takuese në garazh, ambiente shërbimi (dyqane) dhe apartamente për secilin nga pronarët e truallit. Nga verifikimi i dokumentacionit të depozituar, Komisionit i rezultoi se apartamenti që i është shitur shtetasit A.P në vitin 2006 figuron në listën e pasurive të përcaktuara për secilin pronar truall, në aneks kontratën e sipërmarrjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 8.4.2013.

Nga hetimi i kryer rezultoi se deklarata noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 19.9.2014, është raportuar nga noteri edhe në DPPPP¹⁷ me të njëjtin përshkrim dhe burim krijimi për dhurimin e kryer. Këto të ardhura janë si rezultat i shitjes së apartamentit shtetasit A.P nëpërmjet kontratës nr. *** rep., nr. *** kol., datë 23.8.2006.

¹⁶ Me email-in e datës 3.11.2023.

¹⁷ Aneks nr. 37 në dosjen e ILDKPKI-së.

20.7.3.v Subjekti gjithashtu ka depozituar¹⁸ dokumentacion për motrën e bashkëshortit¹⁹, kontratë pune, librezë kontributesh, librezë pune, si dhe vërtetim nga ISSH-ja për bazën e vlerësueshme dhe pagën neto mesatare. Komisioni përllorarit të ardhurat neto sipas legjislacionit të kohës për periudhën 2005 – 2009 dhe i rezultoi se motra e bashkëshortit të subjektit ka përfituar shumën 1.765.630 lekë.

20.7.4 Për sa më sipër, Komisioni nuk konstatoi problematika lidhur me ligjshmërinë e burimeve të krijimit të kësaj pasurie.

20.7.5 Njëkohësisht, Komisioni hetoi në lidhje me ekzistencën e ndonjë konflikti të mundshëm interesi midis subjektit të rivlerësimit, për shkak të ushtrimit të funksionit, dhe shoqërisë “B***” sh.p.k., me administrator B.L. Nga korrespondenca e Komisionit me institucionet punëdhënëse, këto të fundit konfirmojnë²⁰ se ajo nuk ka gjykuar çështje penale/civile/administrative me palë ndërgjyqëse shoqërinë “B***” sh.p.k. apo administratorin B.L. Bazuar në dokumentacion e administruar, Komisioni konstatoi se subjekti nuk gjendet në kushtet e konfliktit të interesit.

20.8 Lidhur me likuidimin e kësaj pasurie

20.8.1 Në kontratën nr. *** rep., nr. *** kol., datë 16.5.2009, mes shoqërisë “B***” sh.p.k. dhe shtetasit E.H (bashkëshorti i subjektit), për blerje apartamenti me sip. 117.26 m², Komuna D, Tiranë, vlera 53.630 euro, citohet se është likuiduar vlera 47.000 euro menjëherë pas nënshkrimit të kontratës dhe pjesa e mbetur prej 6.630 euro do të paguhet në momentin e dorëzimit të apartamentit. Kjo kontratë konfirmohet edhe nga DPPPP-ja²¹, e cila ka raportime për kontratën e porosisë me vlerë 53.630 euro dhe datë transaksioni 16.5.2009. Personi që kryen transaksionin është E.H (bashkëshorti i subjektit).

20.8.2 Komisioni e ka pyetur²² subjektin nëse ishte paguar vlera e mbetur prej 6.630 euro dhe, nëse po, kur ishte likuiduar ajo. Në përgjigje, subjekti ka sqaruar: *“Shuma 6.630 euro është shlyer gjatë vitit 2009. Në DPV-në para fillimit të detyrës bashkëshorti ka deklaruar këtë pasuri me vlerë të plotë dhe nuk ka deklaruar asnjë detyrim ndaj sipërmarrësit investitor. Për shkak se pagesat janë kryer gjatë vitit 2009, bashkëshorti nuk ka ruajtur dokumentacionin e pagesave. Pagesa e vetme pjesore që disponon është pagesa cash në shumën 25.000 euro në Alpha Bank, likuiduar në datën 29.5.2009, me përfitues shoqërinë “B***” sh.p.k., pagesë e kryer për kontratën nr. *** rep., nr. *** kol.”.*

20.9 Komisioni kreu analizën financiare për të parë mundësitë financiare të familjes së bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit për të investuar në këtë pasuri. Analiza është shtrirë për periudhën 1994 – 2009. Pavarësisht se kontrata për blerjen e apartamentit është lidhur në datën 16.5.2009, analiza është shtrirë për gjithë vitin 2009, pasi nuk dihet saktësisht se kur ka përfunduar likuidimi i kësaj pasurie.

20.9.1 Në analizë janë përfshirë të ardhurat dhe shpenzimet e evidentuara, konkretisht:

- të ardhurat nga punësimi për periudhën 1994 – 2009, për znj. E.H (nëna e bashkëshortit);
- të ardhurat nga punësimi për periudhën 1994 – 2009, për z. V.H (babai i bashkëshortit);
- të ardhurat nga punësimi për periudhën 2006 – 2009, për z. E.H (bashkëshorti i subjektit);
- të ardhurat nga punësimi për periudhën 2005 – 2009, për znj. B.H (motra e bashkëshortit të subjektit);

¹⁸ Me email-in e datës 23.10.2023.

¹⁹ E cila ishte në certifikatën e përbërjes familjare të bashkëshortit të saj përpara martesë.

²⁰ Shkresë nr. *** prot., datë 15.9.2023, nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër dhe shkresë nr. *** prot., datë 15.9.2023, nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë.

²¹ Aneks nr. 37 në dosjen e ILDKPKI-së.

²² Me pyetësin nr. 2, datë 13.9.2023, administruar në dosjen e Komisionit.

- të ardhurat nga shitja e apartamentit në Vlorë, të përfituara nëpërmjet kontratës së shitjes nr. ***, datë 5.6.1996, në vlerën 25.000 USD ose 2.750.250 lekë, konvertuar me kursin mesatar të muajit qershor 1996, sipas Bankës së Shqipërisë;
- të ardhurat nga shitja e objektit ish-salla e mbledhjeve J, R, përfituar nëpërmjet kontratës së shitblerjes nr. ***, datë 18.10.2000, në vlerën 1.800.000 lekë;
- të ardhurat nga dhurimi në vlerën 43.000 euro, në janar ***, konsideruar sipas gjithë të dhënave të grumbulluara dhe sipas deklaratës noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 19.9.2014;
- të ardhurat nga kredia²³ në vlerën 700.000 lekë;
- të ardhurat nga interesat bankarë²⁴ sipas *statement*-it përkatës;
- shpenzimet e jetesës për periudhën 1994 – 1999 janë përlllogaritur 66% e të ardhurave nga punësimi;
- shpenzimet e jetesës për periudhën 2000 – 2009 janë përlllogaritur sipas përbërjes familjare (4 persona), duke u bazuar në INSTAT;
- shpenzime për pagesat e kësteve të kredisë (principal + interes);
- kredia e marrë në vlerën 700.000 lekë është supozuar e shpenzuar e gjitha, për sa kohë ajo është tërhequr, si dhe për shkak se në dokumentacionin e administruar qëllimi i saj është përcaktuar për rinovim apartamenti të ndodhur në lagjen “****”, Vlorë;
- investimi për blerjen e objektit ish-salla e mbledhjeve J, R, nëpërmjet kontratës datë 28.9.2000;
- blerja e automjetit tip “JEEP” në vlerën 7.000 euro në vitin 2009 sipas deklaratimit të subjektit;
- blerja e apartamentit në Tiranë sipas kontratës nr. *** rep., nr. *** kol., datë 16.5.2009, në vlerën 53.630 euro;
- blerja e apartamentit në qytetin e Vlorës sipas kontratës nr. ***, datë 11.7.1996, në vlerën 3.000.000 lekë²⁵;
- gjendje *cash* në vlerën 35.000 euro sipas deklaratimit të subjektit se në momentin e investimit për pasurinë apartament në Tiranë në vitin 2009 vetëm 8.000 euro u përdorën nga dhurimi në shumën 43.000 euro, si dhe gjendja në banka në fund të vitit 2009.

20.9.2 Nga përlllogaritjet e kryera, Komisioni²⁶ konstatoi se duket se familja e bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit nuk ka pasur mundësi financiare në shumën 893.857 lekë të investojë në blerjen e apartamentit në vitin 2009, si dhe të përballojë shpenzimet apo investimet e tjera familjare për periudhën 1994 – 2009 dhe, për pasojë, i kaloi subjektit barrën e provës, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, për të provuar të kundërtën e rezultatit.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

20.9.3 Në prapësimet e saj në funksion të barrës së provës, subjekti, në lidhje me gjetjen e Komisionit, ka shpjeguar se diferenca në shumën 893.857 lekë ka rezultuar për shkak se nga ana e babait të bashkëshortit nuk është bërë e mundur të dokumentohen të ardhurat e realizuara prej tij gjatë ushtrimit të aktivitetit bar-restorant (subjekti “J”), regjistruar me kod fiskal *** dhe vendim gjykate nr. ***, datë 6.5.1994, për shkak se në arkivin e Drejtorisë Rajonale Tatimore Vlorë nuk gjendet dosja fizike. Ky aktivitet tregtar, ka sqaruar subjekti (sikurse ka shpjeguar edhe gjatë hetimit), është ushtruar nga prindërit e bashkëshortit në pasurinë në emër të nënës së bashkëshortit, të ndodhur në zonën kadastrale *** (objekt ish-salla e mbledhjeve nr. ***, me sipërfaqe 236 m², si dhe e truallit me sipërfaqe 236 m², pasuri e cila është shitur në datën 18.10.2000 me kontratën nr. ***).

²³ Shkresë nr. *** prot., datë 23.3.2021, nga ProCredit Bank.

²⁴ Shkresë nr. *** prot., datë 16.3.2021, nga Raiffeisen Bank.

²⁵ Depozituar nga subjekti i rivlerësimit me pyetësin nr. 1, datë 11.1.2021.

²⁶ Periudha e analizuar referon faktin se subjekti nuk ishte në detyrë, nuk ka kontribut, si dhe nuk ishte në këtë përbërje familjare, pasi nuk ishte e martuar.

20.9.4 Sipas subjektit, fakti që babai i bashkëshortit është regjistruar, është pajisur me kod fiskal dhe ka qenë i pajisur me licencë për ushtrimin e aktivitetit në vitin 1996, tregon se ai ka paguar edhe të gjitha detyrimet tatimore, si dhe padyshim ka realizuar të ardhura. Për të provuar pretendimet e saj, subjekti ka depozituar dy prova të reja, konkretisht: vërtetimin nr. *** prot., datë 20.3.2019, të Drejtorisë Rajonale Tatimore Vlorë; vërtetimin nr. *** prot., datë 15.11.2023, të Drejtorisë Rajonale Tatimore Vlorë.

20.9.5 Subjekti ka shpjeguar se referuar dokumentacionit të paraqitur dhe akteve të tjera të administruara në fashikull, prindërit e bashkëshortit kanë ushtruar aktivitet tregtar deri në vitin 2000 (kohë në të cilën është shitur pasuria mbi të cilën ushtrohej aktiviteti), por për shkak të kohës së gjatë të kaluar, për shkak se në këtë periudhë të ardhurat e realizuara nuk deklaroheshin në mënyrë elektronike në organet tatimore dhe sistemet elektronike tatimore për të dokumentuar dhe pasqyruar të ardhurat e deklaruara nga subjektet tatimpaguese (sisteme të cilat kanë filluar të ekzistojnë pas vitit 2002 dhe janë konsoliduar në vitin 2010, fillimi i funksionimit të sistemit C@TS), si dhe për shkak të faktit se prindërit e bashkëshortit nuk kanë qenë subjekte deklaruese, e kanë të pamundur të dokumentojnë realizimin e këtyre të ardhurave, që, ashtu siç deklarojnë prindërit e bashkëshortit, kanë qenë të kënaqshme.

20.9.6 Subjekti ka pretenduar pamundësinë objektive lidhur me provueshmërinë e të ardhurave të ligjshme të krijuara nga aktiviteti tregtar i prindërve të bashkëshortit, pasi ka kaluar kohë e gjatë nga perioda për të cilën kërkohet dokumentacioni ligjor rreth 29 vjet më parë dhe në vazhdim ka qenë e pamundur gjetja e dokumentacionit të plotë ligjor për këtë periudhë, ku prindërit e bashkëshortit nuk kanë pasur asnjë detyrim ligjor për ruajtjen e dokumenteve që vërtetonin të ardhurat e realizuara nga ky aktivitet privat, duke referuar edhe jurisprudencën e mbajtur nga Kolegji i Posaçëm i Apelimit²⁷.

20.9.7 Në vijim, subjekti ka parashtruar se kjo pasuri është krijuar (porositur dhe likuiduar vlera e plotë e çmimit të apartamentit) nga bashkëshorti përpara martese dhe përpara se ajo të fillonte të ushtronte funksionin e gjyqtares në janar të vitit 2014 në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Dibër (madje edhe përpara se të emërohej për të kryer stazhin profesional nga nëntor të vitit 2011 në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë). Subjekti ka shpjeguar se pasuria është në pronësi të plotë të bashkëshortit dhe, si e tillë, kjo pasuri konsiderohet si pasuri vetjake për efekt të Kodit të Familjes²⁸ dhe mbetet e tillë edhe pas martese.

20.9.8 Subjekti ka shpjeguar se, sikurse është deklaruar në deklaratën para fillimit të detyrës, në deklaratën *Vetting* dhe gjatë hetimit administrativ të kryer nga Komisioni, pasuria e llojit apartament është blerë nga bashkëshorti sipas kontratës nr. *** rep., nr. *** kol., datë 16.5.2009 dhe e gjithë vlera e apartamentit është shlyer para martese (e cila është lidhur në datën 31.3.2011) dhe para fillimit të detyrës (në datën 10.11.2011 ka filluar stazhin profesional pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë në kuadër të vitit të tretë të Shkollës së Magjistraturës, ndërsa në datën 23.1.2014 ka marrë emërimin përfundimtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Dibër), duke referuar jurisprudencën e mbajtur nga Kolegji i Posaçëm i Apelimit²⁹ dhe Komisioni³⁰.

20.9.9 Në përfundim, subjekti ka kërkuar të zbatohet parimi i objektivitetit dhe proporcionalitetit, duke referuar jurisprudencën e Kolegjit³¹.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

²⁷ Vendim nr. ***, datë 17.3.2022.

²⁸ Pasuria e vënë para martese nuk është pjesë e bashkësisë ligjore, në kuptim të neneve 73 dhe 74 të Kodit të Familjes.

²⁹ Vendim nr. ***, datë 14.6.2022 dhe nr. ***, datë 14.6.2022.

³⁰ Vendim nr. ***, datë 5.12.2019 dhe nr. ***, datë 4.6.2020, të Komisionit.

³¹ Vendim nr. ***, datë 6.12.2021, nr. ***, nr. *** (JR), datë 2.2.2023; nr. *** (JR), datë 16.2.2023 dhe nr. *** (JR), datë 10.6.2022.

20.9.10 Trupi gjykues, në analizë të shpjegimeve të subjektit, dokumentacionit të administruar gjatë hetimit, si dhe në prapësime, në analizë të të gjitha fakteve dhe rrethanave të rezultuara gjatë hetimit administrativ, arsyeton si vijon:

20.9.11 Lidhur me provueshmërinë e të ardhurave të pretenduara prej aktivitetit tregtar të prindërve të bashkëshortit, trupi gjykues konstaton se me provat e paraqitura provohet vetëm fakti që babai i bashkëshortit është regjistruar, pajisur me kod fiskal *** dhe vendim gjykate nr. ***, datë 6.5.1994, i pajisur me licencë për ushtrimin e aktivitetit, porse këto të dhëna nuk arrijnë të provojnë masën/vlerën e të ardhurave të realizuara nga ky subjekt tregtar gjatë kohës së ushtrimit të këtij aktiviteti dhe, si të tilla, ato nuk ndryshojnë rezultatin konstatues të Komisionit gjatë hetimit.

20.9.12 Lidhur me pretendimin e subjektit për pamundësinë objektive të provueshmërisë së të ardhurave të ligjshme të krijuara nga aktiviteti tregtar i prindërve të bashkëshortit, trupi gjykues, në analizë të të dhënave të dala nga provat e depozituara rishtazi nga subjekti, si dhe fakteve të dala gjatë hetimit, duke konstatuar se institucioni i Drejtorisë Rajonale Tatimore Vlorë ka informuar se nuk mund të vërë në dijeni për të ardhurat e realizuara nga ky subjekt gjatë kohës së ushtrimit të këtij aktiviteti, çmon se subjekti nuk ka arritur të provojë plotësimin e kriterëve të nenit 32, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, i cili shprehimisht parashikon se: *“Nëse subjekti i rivlerësimit është në pamundësi objektive për të disponuar dokumentin që justifikon ligjshmërinë e krijimit të pasurive, duhet t’i vërtetohet institucionit të rivlerësimit se dokumenti është zhdukur, ka humbur, nuk mund të bëhet përsëri ose nuk merret në rrugë tjetër”*. Pavarësisht këtij vlerësimi, trupi gjykues, kohën e largët rreth 29 vjet më parë, për të cilën kërkohet dokumentacioni ligjor, faktin se prindërit e bashkëshortit nuk kanë pasur detyrimin ligjor për ruajtjen e dokumenteve që vërtetonin të ardhurat e realizuara nga ky aktivitet privat me burime që duket se vijnë nga një aktivitet i ligjshëm³², i ka mbajtur në konsideratë në vlerësimin tërësor të kësaj çështjeje apo procesit në tërësi për këtë subjekt.

20.9.13 Trupi gjykues në çështjen objekt vlerësimi, në raport me pretendimet e subjektit, çmon se rrethanat faktiko-ligjore, të tilla si: (i) pasuria rezulton të jetë krijuar dhe ka ekzistuar para se subjekti i rivlerësimit të ishte emëruar në detyrë dhe të ishte në martesë; (ii) diferenca në masën 893.857 lekë, e konstatuar në pasurinë e krijuar nga bashkëshorti përpara fillimit të detyrës – janë të pamjaftueshme për të arritur në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për kriterin e kontrollit të pasurisë, sipas përcaktimit të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016 dhe se balanca negative e rezultuar sa më sipër bazuar në parimin e objektivitetit dhe proporcionalitetit nuk cenon procesin e rivlerësimit për subjektin, në përmbushje të qëllimit të këtij ligji.

21. Automjet tip “Daimler Chrysler”, blerë në datën 29.10.2012, me vlerë 500.000 lekë. Burimi i krijimit: në datën 13.9.2012 është bërë kalimi në favor të shtetasit E.H i vlerës 14.000 GBP dhe 103.563 lekë të krijuara si rezultat i ekzekutimit të vendimit të formës së prerë nr. *** të Gjykatës së Apelit Vlorë, që i ka lënë në fuqi vendimin nr. ***, datë 5.03.2012, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë. Pjesa takuese: 100%. Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës disa dokumente³³.

21.1 ILDKPKI-ja në raportin e saj është shprehur: *Konfirmohet deklarami me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjet e ardhura nga DRSHTRR Gjrokastër dhe DPPPP-ja.* (Shitja është

³² Nga dokumentacioni i administruar provohet se babai i bashkëshortit të subjektit është regjistruar, pajisur me kod fiskal *** dhe me licencë për ushtrimin e aktivitetit tregtar.

³³ Certifikatë pronësie nr. ***, për automjetin tip “Daimler Chrysler” me targë ***, në pronësi të shtetasit E.H; vendim nr. ***, datë 29.5.2012, nga Gjykata e Apelit Vlorë, me palë paditëse E.H dhe palë të paditur BKT, dega Vlorë, me objekt “Detyrim për kthim shume”, me të cilin është vendosur të lihet në fuqi vendimi nr. ***, datë 5.3.2012, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë (në të cilin është vendosur pranimi i padisë për kthimin e shumës 14.000 GBP palës paditëse). (Aneks nr. 4/7 në dosjen e ILDKPKI-së).

bërë pas datës së dorëzimit të deklaratës së rivlerësimit dhe është deklaruar nga subjekti në deklaratën e interesave privatë periodikë vjetorë 2017.)

Hetimi i Komisionit

21.2 Bashkëshorti i subjektit deklaroi në DPV-në e vitit 2012: *“Blerje automjeti tip ‘Daimler’, në datën 29.10.2012, në vlerën 500.000 lekë. Burimi i krijimit: një pjesë e të ardhurave të krijuara si rezultat i ekzekutimit të vendimit të formës së prerë nr. *** të Gjykatës së Apelit Vlorë, që ka lënë në fuqi vendimin nr. *** të Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë (pas tërheqjes së shumës nga BKT-ja)”*.

21.3 Nga korrespondenca e Komisionit me DPSHTRR-në, kjo e fundit³⁴ informon se shtetasi E.V.H ka pasur të regjistruar automjetin me targë ***.

21.3.1 Kjo drejtori ka përcjellë dosjen e plotë të mjetit, nga verifikimi i së cilës rezultoi se nëpërmjet kontratës së shitjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 29.10.2012, me palë shitëse shtetasi A.D (përfaqësuar me prokurë nga E.H) dhe palë blerëse shtetasi E.H, është blerë automjeti tip “Daimler Chrysler” me targë ***, në vlerën 500.000 lekë. Rezultoi se mjeti është shitur në vitin 2017 po në vlerën 500.000 lekë dhe më pas ka ndryshuar targën nga pronarët pasardhës në ***.

21.4 Nga dosja konstatohet se ky mjet është zhdoganuar në datën 8.10.2012 sipas deklaratës doganore nr. ***, për vlerë mjeti 1.467.888 lekë dhe TVSH 293.578 lekë. Bashkëshorti i subjektit, z. E.H, ka paguar zhdoganimin e mjetit (TVSH në doganë) në datën 9.10.2012, në vlerën 232.063 lekë.

21.5 Komisioni e ka pyetur³⁵ subjektin mbi shitjen e këtij mjeti në vlerën 500.000 lekë, pasi ai rezultoi i zhdoganuar për vlerën 1.467.888 lekë. Subjekti në përgjigje ka sqaruar: *“...automjeti tip ‘Daimler’ ishte një dakordësim paraprak, i rastësishëm i bashkëshortit me shitësin, në vlerën e lartpërmendur. Meqenëse automjeti ishte i pazhdoganuar është kryer zhdoganimi i tij duke paguar vlerën doganore të përcaktuar nga autoritetet doganore në shumën 232.063 (dyqind e tridhjetë e dy mijë e gjashtëdhjetë e tre) lekë. Më duhet të sqaroj që subjekti shitës nuk e kishte paguar doganën e mjetit në momentin që ishte bërë ky dakordësim, por sipas llogarive të tij ai kishte llogaritur një vlerë shumë më të ulët se ajo që në fakt u pagua. Në lidhje me procedurën e vlerësimit doganor të automjeteve më duhet të sqaroj se... Subjekti shitës ka sjellë automjetin në datën 4.10.2012, sipas fletëhyrjes në praktikën doganore dhe ka kryer deklarimin doganor në datën 8.10.2012, me një vlerë malli prej 300.000 (treqind mijë) lekësh, sipas kuadtratit 22 të deklaratës doganore ***, datë 8.10.2012. Automjeti në momentin e ardhjes në Shqipëri nuk ishte në gjendje të mirë, pasi kishte probleme si nga pamja vizuale (pjesët e llamarinës të goditura, fenerët po ashtu), serviset e motorit të pabëra, gomat me probleme etj. Në këto rrethana, subjekti shitës, mesa i ka shpjeguar bashkëshortit, kishte llogaritur që dogana do t’ia njihte këtë amortizim të mjetit dhe do të bënte një vlerësim më të arsyeshëm në lidhje me detyrimin doganor, por në fakt autoritetet doganore nuk e njohën këtë amortizim dhe e vlerësuan sipas çmimeve të Quattroruote. Autoritetet doganore i kryejnë procedurat doganore sipas ligjit nr. 8449, datë 27.1.1999 (Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë) dhe Udhëzimit nr. 25, datë 30.11.2007, të ministrit të Financave ‘Për procedurat e shqyrtimit të vlerës doganore, burimet e informacionit dhe afatet e publikimit me të dhënat e disponueshme për vlerësimin doganor’. Më duhet të sqaroj se autoritetet doganore nuk përcaktojnë çmimin real të makinës, pasi ai është ekskluzivitet i palëve, të cilët nëpërmjet marrëveshjes (vullnetit të tyre) mund të marrin në konsideratë shumë faktorë si sasia e kilometrave të përshkruar nga automjeti, gjendja motorike, gjendja e tapicerisë etj., por autoritetet doganore përcaktojnë vlerën e mjetit për qëllime doganore, për të përcaktuar detyrimin doganor. Në këtë kontekst, sipas udhëzimit të sipërcituar, autoritetet doganore*

³⁴ Me shkresën nr. *** prot., datë 19.3.2021.

³⁵ Pyetësor nr. 4 datë 9.10.2023, administruar në dosjen e Komisionit.

zbatojnë një nga gjashtë mënyrat e vlerësimit të mallit: 1) pranimin e vlerës sipas transaksionit (faturës); 2) vlera sipas mallrave identikë; 3) vlera sipas mallrave të ngjashëm; 4) vlera e nxjerrë me deduksion; 5) vlera e përlogaritur; 6) vlera sipas të dhënave të disponueshme. Në rastin konkret, në automjetin e bashkëshortit, autoritetet doganore kanë aplikuar metodën e gjashtë sipas kuadratit 43 të deklaratës doganore, duke marrë vlerën sipas revistës “Quattroruotte”, duke mos njohur amortizimin normal të mjetit në momentin e paraqitjes në doganë. Sa më sipër është një procedurë rutinë e doganës dhe është në diskrecion të tyre të vendosin në lidhje me vlerësimin doganor, por në asnjë rast ata nuk pretendojnë që kjo është vlera reale e mallit, por është vlerë e llogaritur për qëllime doganore”.

21.6 Komisioni ka konstatuar se nga dokumentacioni i administruar rezulton se subjekti shitës ka sjellë automjetin në datën 4.10.2012, sipas fletëhyrjes në praktikën doganore dhe ka kryer deklarimin doganor në datën 8.10.2012, me një vlerë malli prej 300.000 lekësh, sipas kuadratit 22 të deklaratës doganore ***, datë 8.10.2012. Bashkëshorti i subjektit ka paguar zhdoganimin e mjetit (TVSH në doganë) në datën 9.10.2012, në vlerën 232.063 lekë dhe, për rrjedhojë, Komisioni ka verifikuar burimet e krijimit të kësaj pasurie, duke përfshirë si shpenzim edhe vlerën e zhdoganimit të automjetit.

21.7 Lidhur me burimin e krijimit

21.7.i Bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ka deklaruar në deklaratën *Vetting* se si burim krijimi për këtë pasuri kanë shërbyer të ardhurat e krijuara si rezultat i ekzekutimit të vendimit të formës së prerë nr. ***, datë 29.05.2012, të Gjykatës së Apelit Vlorë, i cili ka lënë në fuqi vendimin nr. ***, datë 5.03.2012, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.

21.7.ii Për këto të ardhura, subjekti ka depozituar vendimin e formës së prerë nr. ***, datë 29.05.2012, të Gjykatës së Apelit Vlorë.

21.7.iii Komisionit nga hetimi i rezulton se në llogarinë bankare të shtetasit E.H në BKT është kredituar shuma 14.000 GBP, në datën 13.9.2012, me përshkrimin “BKT Vlorë, kalim për E.H në bazë të vendimit të Gjykatës Vlorë nr. ***, datë 5.3.2012, për çështjen E.H”.

21.7.iv Rezultoi se bashkëshorti i subjektit e ka tërhequr këtë shumë sipas datave të mëposhtme.

Tabela nr. 1

Data	Vlera në GBP	Përshkrimi
13.9.2012	1,000	E.H tërheq nga llogaria
13.9.2012	4,000	E.H tërheq nga llogaria
21.9.2012	8,985	E.H tërheq nga llogaria
TOTAL	13,985	

21.7.v Nga totali i tërhequr konstatohet se një pjesë (1.500.000 lekë) është investuar në depozitë, e cila është trajtuar në vijim të këtij vendimi, ndërsa shuma tjetër e mbetur konstatohet se është më se e mjaftueshme për blerjen e mjetit.

21.8 Komisioni e ka pyetur³⁶ subjektin në lidhje me burimin e krijimit të shumës 14.000 GBP, e cila më parë kishte qenë e depozituar në bankë në vitin 2010 nga bashkëshorti i saj. Subjekti ka sqaruar se: “Burim i krijimit të shumave të depozituara në vitin 2010 janë të ardhurat familjare ndër vite të prindërve të bashkëshortit nga pagat e tyre, nga aktiviteti tregtar, si dhe nga shitja e pasurive të paluajtshme, siç është detajuar në pyetësin nr. 02”.

21.8.1 Komisionit nuk i kanë rezultuar problematika lidhur me ligjshmërinë e të ardhurave të familjes së bashkëshortit, ndërsa për të ardhurat e siguruar nga aktiviteti tregtar, subjekti i rivlerësimit nuk ka depozituar dokumentacion për të provuar këtë fakt. Gjithashtu, Komisionit

³⁶ Pyetësor nr. 4, datë 9.10.2023, administruar në dosjen e Komisionit.

nga hetimi i kryer nuk i ka rezultuar ndonjë e dhënë për aktivitet tregtar të zhvilluar nga bashkëshorti apo prindërit e tij.

21.8.2 Komisioni kreu analizën financiare në datën 9.8.2010, kur edhe janë depozituar kursimet në bankë, për të parë mundësinë financiare të familjes së bashkëshortit.

Analiza u shtri për periudhën 1.1.2010 – 9.8.2010, meqenëse periudha përpara ka rezultuar në balancë negative.

21.8.3 Nga hetimi rezultoi se në datën 9.8.2010 bashkëshorti i subjektit ka depozituar në llogarinë e tij bankare në BKT shumat 10.000 GBP dhe 1.110.000 lekë. Po në këtë datë edhe babai i bashkëshortit ka depozituar në llogarinë e tij në BKT shumën 20.000 GBP.

Lidhur me gjendjen *cash*, meqenëse nuk mund të përcaktohet se sa ka qenë vlera e saj në momentin e depozitimeve, Komisioni ka vlerësuar ta marrë atë 0 (zero).

21.8.4 Nga përlllogaritjet e kryera, Komisioni konstatoi se familja e bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit ka pasur mundësi të kryejë depozitimet në bankë, si dhe të përballojë shpenzimet e tjera familjare.

21.9 Komisioni kreu edhe analizën vjetore për të parë mundësitë financiare për të investuar në këtë mjet në vitin 2012, si dhe për të përballuar shpenzimet e tjera familjare, nga ku nuk i rezultuan problematika.

22. Depozitë në Societe Generale Albania Bank në vlerën 1.000.000 lekë. Burimi i krijimit: të ardhura të krijuara si rezultat i ekzekutimit të vendimit të formës së prerë nr. *** të Gjykatës së Apelit Vlorë në shumat 14.000 GBP dhe 103.563 lekë. Në datën 27.12.2012 është hapur depozita me afat në shumën 1.500.000 lekë. Kjo depozitë është pakësuar në datën 28.1.2014, në shumën 300.000 lekë dhe pakësuar në datën 28.3.2014, në shumën 200.000 lekë. Është mbyllur në datën 10.3.2016 dhe riçelur në datën 22.4.2016. Pjesa takuese: 100%. Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës disa dokumente³⁷.

22.1 ILDKPKI-ja në raportin e saj është shprehur: *Konfirmohet deklarimi me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjet e ardhura nga Societe Generale Albania Bank dhe DPPPP-ja.*

Hetimi i Komisionit

22.2 Bashkëshorti i subjektit deklaroi në DPV-në e vitit 2012: *“Në datën 21.9.2012 është hapur depozita optimal në Societe Generale Albania Bank, në shumën 1.740.000 lekë. Në datën 27.12.2012 janë tërhequr 240.000 lekë dhe është hapur depozita me afat në shumën 1.500.000 lekë. Burimi i krijimit: të ardhura të krijuara si rezultat i ekzekutimit të vendimit të formës së prerë nr. ***, datë 29.05.2012, të Gjykatës së Apelit Vlorë, të cilat fillimisht janë ekzekutuar në BKT në 14.000 GBP dhe 103.563 lekë dhe më pas një pjesë e kësaj është depozituar në Societe Generale Albania Bank”.*

22.3 Në DPV-në e vitit 2014, bashkëshorti i subjektit deklaroi pakësimin e depozitës në Societe Generale Albania Bank në datën 28.1.2014, në vlerën 300.000 lekë, si dhe pakësimin e saj në datën 28.3.2014, në vlerën 200.000 lekë.

22.4 Nga korrespondenca e Komisionit me OTP-në³⁸ (ish-Societe Generale Albania Bank), kjo e fundit informon se shtetasi E.V.H ka llogari pranë kësaj bankëe depozitën me afat në monedhën lek, me balancë 1.000.000 lekë.

³⁷ Vendim nr. ***, datë 29.5.2012, i Gjykatës së Apelit Vlorë, me palë paditëse E.H dhe palë të paditur BKT, dega Vlorë, me objekt “Detyrim për kthim shume”, me të cilin është vendosur të lihet në fuqi vendimi nr. ***, datë 5.3.2012, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë (në të cilin është vendosur pranimi i padisë për kthimin e shumës 14.000 GBP palës paditëse). (Aneks nr. 4/7 në dosjen e ILDKPKI-së); konfirmim bankar nga Societe General Albania Bank nr. *** prot., datë 23.1.2017, sipas të cilit shtetasi E.H ka hapur në datën 22.4.2016 depozitë në vlerën 1.000.000 lekë, me afat 12-mujor (aneks nr. 4/8 në dosjen e ILDKPKI-së).

³⁸ Shkresë nr. *** prot., datë 18.3.2021.

22.5 Nga analizimi i lëvizjeve në llogarinë e bashkëshortit të subjektit për vitin 2012, rezultoi se:

- në datën 21.9.2012 është kryer transaksioni me përshkrimin “Blerje valute”, në vlerën 1.740.000 lekë;
- në datën 27.12.2012, shtetasi E.H ka tërhequr *cash* shumën 240.000 lekë;
- në datën 27.12.2012, shtetasi E.H ka hapur depozitë në shumën 1.500.000 lekë.

22.6 Ndërsa, në vitin 2014 bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ka kryer dy tërheqje, përkatësisht:

- 300.000 lekë në datën 28.1.2014;
- 200.000 lekë në datën 28.3.2014.

22.7 Prej vitit 2014 deri në depozitimimin e deklaratës *Vetting*, gjendja e depozitës konstatohet se ka qenë në shumën 1.000.000 lekë.

22.8 Lidhur me burimin e krijimit

22.8.1 Meqenëse shuma e përfituar prej vendimit gjyqësor në vitin 2012 rezultonte e depozituar më parë në bankë në vitin 2010, Komisioni ka analizuar më sipër në këtë vendim mundësinë financiare të familjes së bashkëshortit të subjektit dhe nuk i kanë rezultuar problematika. Në këto kushte u konstatua se bashkëshorti i subjektit dhe familja e tij kanë pasur mundësi për krijimin e tyre.

22.8.2 Komisioni kreu analizën financiare nga momenti i investimit deri në deklaratën *Vetting* dhe nuk i rezultuan problematika për çeljen e kësaj depozite, si dhe mbajtjen e saj të pandryshuar.

23. Llogari rrjedhëse në BKT në shumën 2.273.826,13 lekë. Gjendja e llogarisë në datën 19.1.2017, sipas vërtetimit bashkëlidhur. Llogaria është çelur në datën 27.4.2012. Burimi i krijimit: 1.985.700 lekë kredi sipas kontratës nr. *** rep., nr. *** kol., datë 12.6.2012, notere I.B. Kjo shumë mbeti në gjendje *cash* pas revokimit (me kontratën nr. *** rep., nr. *** kol.) të kontratës për prenotim apartamenti nr. *** rep., nr. *** kol., ndërsa 288.126 lekë kursime. Burimi i krijimit të kursimeve: kontrata e shitjes së apartamentit të shtetasi A.P, me vlerë 43.000 euro, kaluar në janar të vitit 2009 sipas deklaratës noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., notere D.A. Pjesa takuese: 100%. Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës disa dokumente³⁹.

23.1 ILDKPKI-ja në raportin e saj është shprehur: *Konfirmohet deklarimi me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjet e ardhura nga BKT-ja dhe DPPP-ja.*

23.2 BKT-ja⁴⁰ informon se shtetasi E.H ka llogari pranë kësaj banke. Gjendja e llogarisë në datën 29.1.2017, kur është depozituar deklarata *Vetting*, është 2.180.826,13 lekë. Diferenca në vlerën e deklaruar vjen për shkak të referimit të dy datave të ndryshme.

23.3 Lidhur me burimin e krijimit të kësaj llogarie

23.3.1 Në DPV-në e vitit 2016, bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ka deklaruar: *“Llogari në BKT në vlerën 2.499.000 lekë. Sqarohet se kjo shumë nuk është shtesë, por është kalim i kësaj*

³⁹ Vërtetim nr. *** prot., datë 19.1.2017, nga BKT, sipas të cilit shtetasi E.H ka llogari me gjendje 2.273.826 lekë; deklaratë noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 19.9.2014, me deklarues A.H e E.H, ku shtetasi A.H deklaroi se në cilësinë e pronarit të truallit në lagjen “****”, Vlorë, ka përfituar nga ndërtimet e bëra mbi këtë truall apartamente banimi. Vlerën e një apartamenti që ia ka shitur shtetasi A.P nëpërmjet kontratës nr. *** rep., nr. *** kol., datë 23.8.2006, në shumën 43.000 euro, ia ka dhënë nipit të tij E.H në janar të vitit 2009, për nevojat e tij. Shuma është dhënë pa shkresë në kushtet që deklaruesit janë në marrëdhënie të posaçme; kontratë sipërmarrjeje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 23.8.2006, me palë pronare truallit A.H dhe palë porositore A.P, ku pala e parë nga përfitimi i apartamenteve nga ndërtimi në truallin e tij nga shoqëria “A. I. K” sh.p.k. i shet një apartament palës blerëse me sip. 109 m², në vlerën 43.600 euro; kontratë kredie nr. ***rep., nr. *** kol., datë 12.6.2012, me palë kredidhënëse BKT, palë kredimarrëse E.H, dorëzuanës Gilda Hoxha, J.LL e A.LL, vlera 1.985.700 lekë, qëllimi i kredisë për likuidimin e vlerës së mbetur të çmimit të blerjes së apartamentit dhe shuma do të transferohet në favor të shitësit të objektit të shoqëria “A. K” sh.p.k. (aneks nr. 4/5 dhe nr. 4/9 në dosjen e ILDKPKI-së).

⁴⁰ Me shkresën nr. *** prot., datë 23.3.2021.

shume nga likuiditete të zotëruara në gjendje cash dhe të deklaruara në deklaratat e mëparshme...”.

23.3.2 Nga hetimi rezulton që në deklaratat e mëparshme bashkëshorti i subjektit ka deklaruar vetëm në atë të vitit 2012 se ka 4.500.000 lekë *cash* pas revokimit të kontratës për prentim apartamenti, bërë në datën 9.3.2012 me nr. ***rep., nr. *** kol. Kontrata e mësipërme është revokuar në datën 3.7.2012 me kontratën nr. *** rep., nr. *** kol.

23.3.2.i Meqenëse për vitet në vijim, 2013 – 2015, bashkëshortët nuk kanë deklaruar ndryshime, pra shtesa/pakësime të gjendjes *cash*, Komisioni e ka mbartur këtë shumë të pandryshuar në vitet në vijim, ndërsa në vitin 2016 gjendja *cash* është pakësuar me vlerën 2.499.000 lekë.

23.3.2.ii Nga analizimi i *statement*-it rezulton se bashkëshorti i subjektit ka depozituar në llogarinë e tij bankare në BKT shumën totale prej 2.499.000 lekësh me tri transaksione, përkatësisht: (a) në datën 6.10.2016 shumën 850.000 lekë; (b) në datën 12.10.2016 shumën 800.000 lekë; (c) në datën 17.10.2016 shumën 849.000 lekë.

23.4 Komisioni kreu analizën financiare për vitet 2012 – 2016 nga momenti i disponimit të gjendjes *cash* dhe depozitimit të tyre në bankë, për të parë mundësitë financiare të subjektit të rivlerësimit për ta mbajtur të pandryshuar gjendjen *cash*, si dhe të përballojë të gjitha shpenzimet e tjera familjare dhe nuk i rezultuan problematika.

24. Kursime cash në shumën 1.500.000 lekë, të mbetura pas shitjes së apartamentit shtetasit A.P, me vlerë 43.000 euro, sipas kontratës së shitjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 23.8.2006, kaluar në janar të vitit 2009 sipas deklaratës noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., notere D.A. Pjesa takuese: 100%. Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës disa dokumente⁴¹.

24.1 ILDKPKI-ja në raportin e saj është shprehur: *Konfirmohet deklarimi me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjen e ardhur nga DPPPP-ja.*

Hetimi i Komisionit

24.2 Lidhur me kursimet *cash*, rezultoi se subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti i saj kanë kryer deklarime periodike, si në tabelën më poshtë:

Tabela nr. 2

Viti	Përshkrimi sipas subjektit në deklaratat periodike	Vlera e deklaruar	Shuma e akumuluar sipas Komisionit
2012	4.500.000 lekë cash, të përfituara pas revokimit të kontratës për prentim apartamenti, bërë në datën 9.3.2012, me nr. *** rep., nr. *** kol. Kontrata e mësipërme është revokuar më 3.7.2012, me kontratën nr. *** rep., nr. *** kol.	4,500,000	4,500,000
2013	Nuk ka deklarim		4,500,000
2014	Nuk ka deklarim		4,500,000
2015	Nuk ka deklarim		4,500,000

⁴¹ Deklaratë noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 19.9.2014, me deklarues A.H e E.H, ku shtetasi A.H deklaroi se në cilësinë e pronarit të truallit në lagjen “***”, Vlorë, ka përfituar nga ndërtimet e bëra mbi këtë truall apartamente banimi. Vlerën e apartamentit që ia ka shitur shtetasit A.P nëpërmjet kontratës nr. *** rep., nr. *** kol., datë 23.8.2006, në shumën 43.000 euro, ia ka dhënë nipit të tij E.H në janar të vitit 2009, për nevojat e tij. Shuma është dhënë pa shkresë, në kushtet që deklaruesit janë në marrëdhënie të posaçme; kontratë sipërmarrjeje nr. ***rep., nr. *** kol., datë 23.8.2006, me palë pronare trualli A.H dhe palë porositëse A.P, ku pala e parë nga përfitimi i apartamenteve nga ndërtimi në truallin e tij nga shoqëria “A. I. K” sh.p.k. i shtet një apartament palës blerëse me sip. 109 m², në vlerën 43.600 euro (aneks nr. 4/9 në dosjen e ILDKPKI-së).

2016	<i>Llogari në BKT në vlerën 2.499.000 lekë. Sqarohet se kjo shumë nuk është shtesë, por është kalim i kësaj shume nga likuiditete të zotëruara në gjendje cash dhe të deklaruara në deklaratat e mëparshme.</i>	- 2,499,000	2,001,000
deklarata Vetting	<i>1.500.000 lekë cash kursime të mbetura pas shitjes së apartamentit të shtetasi A.P, me vlerë 43.000 euro, sipas kontratës së shitjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 23.8.2006, kaluar në janar të vitit 2009 sipas deklaratës noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., notere D.A</i>	1,500,000	

24.3 Komisioni e ka pyetur⁴² subjektin e rivlerësimit lidhur me shumën e mbetur në fund të vitit 2016 pas depozitimit në llogarinë bankare në BKT, në raport me gjendjen *cash* të deklaruar në deklaratën *Vetting* (janar 2017), e cila në përgjigje ka shpjeguar: “...gjatë vitit 2014, pasi isha emëruar gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Dibër, kemi shpenzuar për mobilimin e apartamentit shumë 500.000 lekë, e cila ka patur si burim gjendjen *cash* të sipërcituar. Në DPV-në e vitit 2014, për arsye se mobilimi është pjesë-pjesë, nuk kam pasur detyrimin të deklaroj shpenzimin e mobilimit e, për rrjedhojë, kemi harruar të deklarojmë pakësimin e gjendjes *cash* në shumën 500.000 lekë. Nga pjesa e mbetur e kursimeve *cash* në shumën 4.000.000 lekë bashkëshorti ka depozituar në bankë gjatë muajit tetor të vitit 2016 shumë 2.500.000 lekë dhe pjesa tjetër 1.500.000 lekë ka qenë gjendje *cash* dhe është deklaruar në deklaratën *Vetting*”. Subjekti ka vijuar të shpjegojë se në deklaratën *Vetting* për pasurinë llogari rrjedhëse në BKT, bashkëshorti ka deklaruar dy burime krijimi të kësaj shume, kredinë e marrë në vitin 2012 dhe shumën e dhuruar nga xhaxhai (e cila ka shërbyer si burim për krijimin e gjendjes *cash* të deklaruar në DPV-në para fillimit të detyrës në vitin 2011). Ndërsa për gjendjen *cash* në shumën 1.500.000 lekë, pasi është konsumuar shuma e kredisë në krijimin e pasurisë më lart, ka deklaruar si burim krijimi vetëm shumën e dhuruar nga xhaxhai”.

24.4 Komisioni, pavarësisht shpjegimit të prezantuar nga subjekti, ka vlerësuar të mos e marrë në konsideratë pakësimin e gjendjes *cash* me 500.000 lekë për vitin 2014, pasi nuk rezultoi që ky pakësim të jetë deklaruar në DPV-në e vitit 2014.

25. Interesa të përfituar si rezultat i depozitës në Societe Generale Albania Bank, në vlerën 102.814 lekë. Pjesa takuese: 100%. Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës konfirmim bankar⁴³ nga Societe Generale Albania, datë 26.1.2017, sipas të cilit shtetasi E.H ka përfituar interesa nga depozitat në vlerë totale 102.814 lekë.

25.1 ILDKPKI-ja në raportin e saj është shprehur: *Konfirmohet deklarimi me dokumentacionin e dorëzuar.*

25.2 Nga korrespondenca e Komisionit me OTP Bank⁴⁴ dhe analizimi i *statement*-it rezultoi se janë përfituar 100.685,44 lekë interesa për periudhën 2012 – 2016.

DETYRIME FINANCIARE

26. Kredi për blerje apartament banimi (kredimarrës) në datën 12.6.2012, në shumën 1.985.700 lekë, me 3% në vit, me afat 20 vjet. Kësti mujor: 11.046 lekë. Fillon në datën 12.6.2012 dhe përfundon në datën 12.6.2032. Gjendja e detyrimit në datën 19.1.2017, në shumën 1.629.675,31 lekë.

Trupi gjykues këtë çështje e ka trajtuar më sipër në këtë vendimmarrje dhe për këtë shkak çmon të mos bjerë në përsëritje.

Lidhur me destinacionin e kredisë

⁴² Pyetësor nr. 2, datë 13.9.2023, administruar në dosjen e Komisionit.

⁴³ Aneks nr. 4/10 në dosjen e ILDKPKI-së.

⁴⁴ Shkresë nr. *** prot., datë 18.3.2021.

26.1 Sipas kontratës së kredisë nr. *** rep., nr. *** kol., datë 12.6.2012, rezulton se bashkëshorti i subjektit E.H ka nënshkruar kontratën e kredisë për shumën 1.985.700 lekë, me qëllim likuidimin e vlerës së mbetur të çmimit të blerjes së apartamentit. Në kontratë citohet se shuma e disbursuar do të transferohet nga llogaria e kredisë në favor të shitësit të objektit të kredituar, shoqërisë “A.K” sh.p.k., me transfertë bankare nëpërmjet BKT-së. Dorëzanës për këtë kredi janë subjekti i rivlerësimit Gilda Hoxha dhe prindërit e saj J. dhe A.LL.

26.2 Rezultoi se kolateral për këtë kredi është vendosur pasuria apartament me sip. 73 m² në qytetin e Vlorës, e prindërve të subjektit të rivlerësimit, vërtetuar me kontratën e hipotekimit nr. *** rep., nr. *** kol., datë 12.6.2012.

26.3 Nga analizimi i *statement*-it rezultoi se kredia është disbursuar në datën 26.6.2012, në vlerën 1.985.700 lekë dhe në datën 27.6.2012 është transferuar shuma 1.958.000 në llogari të shoqërisë “A.K” sh.p.k., me përshkrimin “E.H kalon për blerje apartamenti”.

26.4 Subjekti ka depozituar së bashku me deklaratën *Vetting*:

i) Kontratë prenotim apartamenti nr. *** rep., nr. *** kol., datë 9.3.2012, me palë sipërmarrëse shoqëria “A.K” sh.p.k. dhe palë porositëse E.H, për porositje apartamenti me sip. 79.85 m², lagjja “****”, Vlorë. Çmimi i shitjes është 4.500.000 lekë, ku likuidimi do të kryhet si më poshtë:

- kësti i parë prej 2.500.000 lekësh është likuiduar në janar të vitit 2012;
- kësti i dytë prej 2.000.000 lekësh do të likuidohet deri në prill të vitit 2012.

ii) Revokim kontrate nr. *** rep., nr. *** kol., datë 3.7.2012, ku shoqëria “A.K” sh.p.k. dhe shtetasi E.H revokojnë kontratën për prenotim apartamenti nr. *** rep., nr. *** kol., datë 9.3.2012, ku citohet se blerësit i është kthyer shuma e paguar jashtë zyrës noteriale.

26.5 Komisioni e ka pyetur⁴⁵ subjektin lidhur me burimin e krijimit të shumës që ka shërbyer për likuidimin e kësaj pasurie, si dhe arsyet e revokimit të kontratës së prenotimit të apartamentit. Në përgjigje subjekti ka sqaruar se: “*Burimi i krijimit të kësaj shume janë:*

- 2.542.000 lekë, pjesë nga shuma 35.000 euro, që bashkëshorti i ka deklaruar si gjendje cash në deklarimin fillestar para fillimit të detyrës (nëntor 2011). Shuma 35.000 euro (nga të cilat bashkëshorti përdori 2.542.000 lekë për pagesën e këstit të parë) ka si burim shumën 43.000 euro të dhuruar nga xhaxhai në janar të vitit 2009. Ky fakt, për shkak të marrëdhënies së posaçme familjare (si dhe mosmbartjes së detyrimit për deklarim nga ana e bashkëshortit), është dokumentuar në deklaratën noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 19.9.2014, të shtetasit A.H.

- 1.958.000 lekë kanë si burim shumën e disbursuar sipas kredisë bankare nr. *** rep., nr. *** kol., datë 12.6.2012, e cila pas revokimit të kontratës i është kthyer bashkëshortit.

Në lidhje me arsyet e revokimit të kësaj kontrate, dua të sqaroj se në datën 10.11.2011 kam filluar stazhin profesional në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë (pas kërkesës dhe dëshirës time, duke qenë se isha me një fëmijë të sapolindur dhe kisha nevojë për ndihmën e prindërve të mi dhe të bashkëshortit) në kuadër të vitit të tretë të kryerjes së Shkollës së Magjistraturës. Pas përfundimit të stazhit profesional dhe renditjes përfundimtare që bëhet nga Shkolla e Magjistraturës, renditje e cila në atë kohë ka pasur rëndësi në emërimin përfundimtar të magjistratëve sipas nenit 20 të ligjit nr. 8136, datë 31.7.1996 “Për Shkollën e Magjistraturës”⁴⁶, kuptuam në bazë të renditjes përfundimtare në raport me vendet vakante që kishte në atë kohë në sistemin e drejtësisë që jo vetëm nuk kishim asnjë mundësi për t’u emëruar

⁴⁵ Pyetësor nr. 2, datë 13.9.2023, administruar në dosjen e Komisionit.

⁴⁶ Neni 20 i ligjit nr. 8136, datë 31.7.1996, parashikon: “*Drejtoria e shkollës i dërgon Presidentit të Republikës të dhënat e procesit të vlerësimit për të bërë emërimin përfundimtar të tyre në vendet vakante, në përputhje me shkallën e vlerësimit të tyre nga shkolla, pas propozimeve të bëra, përkatësisht, nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë për gjyqtarët dhe nga Prokurori i Përgjithshëm për prokurorët*”.

përfundimisht në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë, por emërimi përfundimtar do të ishte në një gjykatë gjeografikisht të largët në raport me vendbanimin tim në atë kohë, që ishte qyteti i Vlorës.

*Në këto rrethana, dhe në kushtet kur ne nuk do të jetonim më në qytetin e Vlorës, e konsideruam të panevojshme blerjen e një apartamenti, çka diktoi vendimmarrjen për revokimin e prenotimit të apartamentit, revokim i cili u krye me kontratë për revokim blerjeje apartamenti me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 3.7.2012. Vlera e paguar për blerjen e apartamentit në momentin e revokimit iu kthye cash bashkëshortit nga shoqëria, sipas mandatit të arkëtimit të datës 3.7.2012.*

*Sikurse rezultoi më vonë, me vendimin nr. *** , datë 18.1.2013, ish-Këshilli i Lartë i Drejtësisë i ka propozuar Presidentit të Republikës emërimin përfundimtar të 8 magjistratëve, që kishin mbaruar vitin e tretë të Shkollës së Magjistraturës në vitin 2011 – 2012. Në bazë të këtij vendimi jam propozuar për t'u emëruar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë. Presidenti i Republikës në atë kohë nuk dekretoi brenda afatit ligjor 8 magjistratët e propozuar nga ish-Këshilli i Lartë i Drejtësisë, në datën 18.1.2013. Më pas, me vendimin nr. *** , datë 17.1.2014, rezulton se ish-Këshilli i Lartë i Drejtësisë i ka propozuar Presidentit të Republikës emërimin përfundimtar të magjistratëve që kanë përfunduar studimet për vitin akademik 2011 – 2012 dhe 2012 – 2013. Në përfundim (pasi kam qenë në pritje të emërimit përfundimtar në periudhën korrik 2012 – janar 2014, duke mos e ushtruar “de facto” detyrën e gjyqtarës), me Dekretin nr. *** , datë 23.1.2014, sipas pritshmërive tona, jam emëruar përfundimisht në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Dibër, çka e bënte të pamundur vazhdimin e jetesës në qytetin e Vlorës, për shkak të distancës së madhe gjeografike mes vendbanimit dhe vendit të ushtrimit të detyrës”.*

Në mbështetje të deklaramentit, subjekti ka depozituar:

- i. kontratë kredie bankare nr. *** rep., nr. *** kol., datë 12.6.2012;
- ii. deklaratë noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 19.9.2014, e shtetasit A.H;
- iii. kontratë për prenotim apartamenti nr. *** rep., nr. *** kol., datë 9.3.2012;
- iv. kontratë për revokim blerje apartamenti nr. ***rep., nr. *** kol., datë 3.7.2012;
- v. Dekret nr. **, datë 10.11.2011 “Për caktimin e përkohshëm të kandidatëve për magjistratë, për të kryer stazhin profesional si gjyqtarë”;
- vi. Dekret nr. *** , datë 23.1.2014 “Për emërimin përfundimtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Dibër”;
- vii. vendim nr. *** , datë 18.1.2013, të ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë;
- viii. vendim nr. *** , datë 17.1.2014 “Për disa propozime për emërimin përfundimtar të magjistratëve të cilët kanë mbaruar vitin e tretë të Shkollës së Magjistraturës, në vitet akademike 2011 – 2012 dhe 2012 – 2013, në gjykatat e rretheve gjyqësore” të ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë;
- ix. dokumentacion për kthimin e shumës 4.500.000 lekë, nga shoqëria “A.K” sh.p.k. (mandatarkëtimi nr. *** , datë 3.7.2012).

26.6 Komisioni e ka trajtuar në këtë vendimmarrje burimin e krijimit të shumës 35.000 euro si vlerë e mbetur nga shuma 43.000 euro, dhuruar nga xhaxhai, dhe nuk i kanë rezultuar problematika.

26.7 Komisioni e ka pyetur subjektin lidhur me disponimin *cash* të shumës 35.000 euro, pasi në deklaratën para fillimit të detyrës bashkëshorti i saj deklaronte në rubrikën e angazhimeve dhe veprimtarive private dhe/ose publike përfshirjen në *veprimtari tregtare ortak me 50% të shumës për veprimtarinë në Vlorë në shoqërinë “M.H” sh.p.k., sipas deklaratës noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., shuma e të ardhurave të krijuara në lek apo në valut 35.000 euro.*

26.7.i Subjekti në përgjigje ka qartësuar: “...bashkëshorti, me deklaratën noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 31.3.2011, së bashku me shtetasen C.P (administratore e vetme e shoqërisë “M.H” sh.p.k.) kanë marrë përsipër ushtrimin e një aktiviteti tregtar me NIPT sekondar të

shoqërisë “M.H” sh.p.k., duke deklaruar se aktivitetin në këtë njësi do ta zhvillonin bashkërisht, ku detyrimet, shpenzimet, investimet dhe fitimet do të përballoheshin nga të dy në masën 50% me 50%.

Nga leximi i prokurës së posaçme nr. ***rep., nr. *** kol., datë 31.3.2011, si dhe në deklaratën noteriale nr. ***rep., nr. *** kol., datë 31.3.2011, nuk rezulton e rregulluar qartë mënyra se si ata do të bashkëpunonin ndërmjet tyre, pasi shoqëria “M.H” sh.p.k., me NIPT ***, kishte si ortakë të vetme shtetasen italiane C.P dhe aktiviteti tregtar do të zhvillohej me NIPT sekondar të kësaj shoqërie. Gjithashtu, ortakja dhe përfaqësuesja ligjore e vetme e shoqërisë i kishte dhënë të drejtën bashkëshortit të nënshkruante kontratën për marrjen me qira të ambienteve në qendrën “R”. Sipas të dhënave të regjistrimit tregtar adresa sekondare e kësaj shoqërie në Vlorë është hapur në datën 3.9.2011, në ambientin e marrë me qira sipas kontratës së po kësaj date, lidhur midis shtetasit D.Ç, me cilësinë e qiradhënësit dhe shoqërisë “M.H” sh.p.k., përfaqësuar nga administratorja C.P. Bashkëshorti deklaroi se shtetasja C.P nuk iu përmbajt marrëveshjes së nënshkruar për ta përfshirë bashkëshortin ligjor në një nga format e parashikuara në ligjin për tregtarët dhe shoqëritë tregtare. Sipas bashkëshortit, shtetasja italiane pas nënshkrimit të dy akteve noteriale të sipërcituara krijoi kontakte të drejtpërdrejta me palët e treta në Vlorë (gjatë periudhës mars – shtator 2011)⁴⁷ dhe veprimi drejtpërdrejt pa përfaqësimin e bashkëshortit. Bashkëshorti deklaroi se vlera e investimit që ai kishte menduar për t’u përfshirë në këtë bashkëpunim (si ortak, shoqëri e re apo formë tjetër ligjore), sipas bisedimeve edhe me shtetasen C.P ishte 35.000 euro, sa ai zotëronte cash në momentin e lidhjes së marrëveshjes. Meqenëse deri në fund të vitit 2011 ai së bashku me shtetasen C.P nuk mundën të gjenin dakordësinë për një formë ligjore bashkëpunimi, ndërkohë që kjo shtetase kishte filluar ushtrimin e aktivitetit në qytetin e Vlorës dhe nuk kishte më nevojë për ndihmën e bashkëshortit, ai e konsideroi të prishur marrëveshjen dhe hoqi dorë nga bashkëpunimi i mëtejshëm me të. Duket qartë nga përshkrimi i sipërcituar dhe dokumentacioni bashkëlidhur kësaj përgjigjeje se është pasaktësi në DPV-në para fillimit të detyrës deklarimi nga bashkëshorti i shumës 35.000 euro, në faqen 11 të kësaj deklarate, në rubrikën “Angazhime dhe veprimtari private dhe/ose publike”, si e ardhur e krijuar në lekë apo në valutë. Siç u shpjegua më sipër, kjo ishte vlera që bashkëshorti mendonte të investonte për t’u përfshirë si ortakë në këtë aktivitet. Në momentin e përpilimit të deklaratës para fillimit të detyrës, bashkëshorti dhe shtetasja C.P akoma vazhdonin diskutimet për të gjetur mënyrën e bashkëpunimit. Është jo logjike të mendohet se nga data e hapjes së adresës sekondare deri në datën e emërimit tim në detyrë, 10.11.2011⁴⁸, të jenë krijuar 35.000 euro të ardhura nga shoqëria “M.H” sh.p.k., me NIPT *** dhe akoma më pak të ardhura nga bashkëshorti im. Për sa më sipër, shuma 35.000 euro e zotëruar cash nga bashkëshorti (dhe e destinuar prej tij për t’u investuar në shoqëri) ishte gjendje në datën 31.12.2011 dhe, siç rezulton nga dokumentacioni, nuk u investua në këtë aktivitet. Pasaktësinë e sipërcituar e kemi korrigjuar me procesverbalin e mbajtur nga ILDKPKI-ja në datën 22.9.2014, jashtë procesit të rivlerësimit”.

Subjekti i rivlerësimit, në mbështetje të deklaramit, ka depozituar:

- a. deklaratë noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 31.3.2011;
- b. prokurë të posaçme nr. *** rep., nr. *** kol., datë 31.3.2011;
- c. kontratë qiraje datë 3.9.2011, lidhur midis shtetasit D.Ç me cilësinë e qiradhënësit dhe shoqërisë “M.H” sh.p.k., përfaqësuar nga administratorja C.P;
- d. ekstrakt historik të shoqërisë “M.H” sh.p.k. dhe vendim nr.***, datë 2.9.2011, të shoqërisë për hapjen e adresës sekondare;
- e. procesverbal të mbajtur nga ILDKPKI-ja në datën 22.9.2014.

⁴⁷ Nga data e nënshkrimit të deklaratës noteriale, 31.3.2011, deri në datën 3.9.2011, datë në të cilën është nënshkruar kontrata e qirasë.

⁴⁸ Datë deri në të cilën deklaroheshin gjendja e pasurive.

26.8 Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar edhe lidhur me likuiditetet e zotëruara nga bashkëshorti i saj, ku ndër të tjera, ka shpjeguar: *“Bashkëshorti e ka mbajtur cash këtë shumë, pasi gjithmonë ka menduar krijimin e një aktiviteti tregtar. Meqenëse në vitin 2011 nuk arriti ta finalizonte aktivitetin tregtar që ai mendonte, dëshira e tij ka qenë gjithmonë për një investim... Arsyeya e aplikimit për kredi nga ana e bashkëshortit ishte për të plotësuar vlerën për blerjen e apartamentit në qytetin e Vlorës, pasi në atë kohë ne mendonim se do të jetonim në atë qytet. Por, siç kam sqaruar edhe në pyetësin nr. 2, datë 13.9.2023, duke qenë se kuptuam se në bazë të renditjes përfundimtare në raport me vendet vakante që kishte në atë kohë në sistemin e drejtësisë jo vetëm nuk kishim asnjë mundësi për t’u emëruar përfundimisht në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë, por emërimi përfundimtar do të ishte në një gjykatë gjeografikisht të largët në raport me vendbanimin tim në atë kohë që ishte qyteti i Vlorës, bashkëshorti e revokoi kontratën për blerjen e apartamentit”.*

26.9 Nga korrespondenca me ILDKPKI-në⁴⁹ Komisioni administroi procesverbalin e mbajtur më 22.9.2014, në të cilin vërehet se subjekti ka qartësuar mbi deklaratimet e bashkëshortit në deklaratën para fillimit të detyrës. Edhe në këtë procesverbal subjekti ka qartësuar se shuma 35.000 euro zotërohej *cash* nga bashkëshorti në datën e deklaratimit të parë, 10.11.2011, dhe se kjo shumë zotërohej prej tij para lidhjes së martesës në kohën kur nuk kanë qenë subjekt deklarami.

26.10 Komisioni konstatoi se subjekti ka dhënë të njëjtat shpjegime si në procesverbalin e mbajtur në vitin 2014 edhe gjatë hetimit administrativ të kryer.

26.11 Komisioni, vlerësoi ta marrë shumën 35.000 euro si gjendje *cash* në fund të vitit 2011, pasi konstatoi faktet e përshkruara në vijim:

26.11.i Rezultoi se kjo shumë është deklaruar si e ardhur nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit në deklaratën para fillimit të detyrës të vitit 2011.

26.11.ii Bashkëshorti i subjektit nuk rezultoi i regjistruar si ortak dhe nuk u provua me dokumentacion se kishte realizuar të ardhura nga aktiviteti në shoqërinë “M.H” sh.p.k.

26.11.iii Rezultoi se subjekti i rivlerësimit është pyetur në ILDKPKI me procesverbalin datë 22.9.2014 dhe ka sqaruar se shuma 35.000 euro zotërohej *cash* nga bashkëshorti në momentin e deklaratimit para fillimit të detyrës së vitit 2011.

26.11.iv Lidhur me burimin e krijimit të kësaj shume, subjekti ka deklaruar përgjatë hetimit administrativ⁵⁰, por edhe në procesverbalin e mbajtur në ILDKPKI në vitin 2014, se kjo shumë është rrjedhojë e shumës 43.000 euro, dhuruar bashkëshortit nga xhaxhai i tij në vitin 2009.

26.11.v Nga të dhënat e administruara dhe analizuar më sipër në këto rezultate, rezultoi se dhuruesi/xhaxhai i bashkëshortit ka pasur mundësi të dhurojë shumën 43.000 euro.

26.11.vi Rezultoi e provuar përgjatë hetimit administrativ se në vitin 2009 bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit nuk ishte në lidhje martesore me këtë të fundit, pasi martesa e tyre daton më 11.3.2011.

26.11.vii Po përgjatë hetimit administrativ rezultoi e provuar se subjekti i rivlerësimit në vitin 2009 nuk ushtronte detyrën e gjyqtares, por vijonte studimet në Shkollën e Magjistraturës.

26.11.viii Rezultoi e provuar se subjekti i rivlerësimit ka kryer stazhin profesional në vitin kalendarik 2011 – 2012 dhe më pas nuk e ka ushtruar detyrën e gjyqtares deri në vitin 2014, kur edhe është dekretuar nga Presidenti i Republikës së Shqipërisë.

26.11.ix Rezultoi se një pjesë e shumës 35.000 euro është depozituar në vitin 2016 në llogarinë bankare në BKT të bashkëshortit të subjektit.

⁴⁹ Shkresë nr. *** prot., datë 22.9.2023.

⁵⁰ Me pyetësin nr. 2, datë 13.9.2023, administruar në dosjen e Komisionit.

26.11.x Trupi gjykues, në këtë çështje objekt vlerësimi, çmoi se bashkëshorti i subjektit ka kryer deklaram të pasaktë lidhur me këtë likuiditet në deklaratën para fillimit të detyrës. Në aspektin e besueshmërisë sa i përket çmuarjes së pasaktësisë në deklaram, trupi gjykues konsideron veç fakteve të rezultuar më sipër edhe ato në vijim, për sa ka konstatuar:

26.11.xi Në deklaratën *Vetting*, subjekti ka kryer deklaram të plotë, duke identifikuar personin dhurues, ku nga hetimi shuma e dhuruar rezultoi me burime të ligjshme.

26.11.xii “I afërmi” i bashkëshortit të subjektit, në cilësinë e dhuruesit, identifikohet në DPV-në e vitit 2011 për pasurinë e krijuar në 2009-ën, ku përdoret pjesërisht shuma e dhuruar. Kështu, në DPV-në e vitit 2011, bashkëshorti i subjektit deklaroi pasurinë e krijuar në vitin 2009 dhe burimin e krijimit të saj, me përshkrimin “Apartament 120 m², adresa Komuna D, Tiranë. Burim krijimi: kursime nga puna dhe ndihmë nga prindërit dhe të afërm”.

26.11.xiii Përveç faktit konstatues se përgjatë hetimit nuk rezultuan deklarime kontradiktore të subjektit për këtë çështje, trupit gjykues i rezultoi nga procesverbali për marrjen në pyetje të subjektit nga ILDKPKI-ja se në vitin 2014 është ndrequr pasaktësia e konstatuar në DIPP-në e vitit 2011, e cila përbën provë në kuptim të nenit 49, pika 1, shkronja “c” e ligjit nr. 84/2016 dhe është vlerësuar si i tillë edhe në qëndrimin e konsoliduar të Kolegjit⁵¹, ku, ndër të tjera, citohet: “...përpilimi i këtij dokumenti zyrtar jo vetëm që është bërë nga organi kompetent në përputhje me procedurën dhe formën e kërkuar prej ligjit, por ai daton në një kohë të largët e pa lidhje me kontekstin e procesit të rivlerësimit e në zbatim të tagrave ligjorë të tij, duke krijuar bindjen se të dhënat e përfuara në këtë dokument nëpërmjet shpjegimeve të dhëna nga subjekti kanë shëruar pasaktësitë në deklarime të subjektit të rivlerësimit në funksion të zbatimit të ligjit nr. 9049/2003, në mënyrë autonome nga procesi i rivlerësimit”.

26.11.xiv Në këtë çështje objekt vlerësimi, trupi gjykues mban në konsideratë faktin se veprimet juridike, si deklarama e dhurimit dhe kontrata e blerjes së pasurisë në qytetin e Vlorës, janë deklaruar pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave pa përfshirje të subjektit të rivlerësimit dhe të kryera para fillimit të detyrës prej saj, duke mos impaktuar në këtë mënyrë pozitive të subjektit në këtë proces.

26.12 Nga përlogaritjet e kryera për periudhën 10.8.2010 – 10.11.2011 (datë e deklarimit të parë para fillimit të detyrës), Komisioni konstatoi se bashkëshorti dhe familja e tij kanë pasur mundësi të krijojnë shumën 35.000 euro, si dhe të përballojnë shpenzimet e tjera familjare.

26.13 Lidhur me likuidimin e pasurisë

26.13.1 Komisioni konstatoi se meqenëse bashkëshorti i subjektit ka disponuar *cash* shumën 35.000 euro në fund të vitit 2011, kjo vlerë është më se e mjaftueshme për të paguar në janar të vitit 2012 kështu e parë prej 2.500.000 lekësh, ndërsa lidhur me kështu e dytë u konstatua se burimi i tij është kredia dhe se pas disbursimit të saj e gjithë vlera është kaluar në llogarinë e shoqërisë së ndërtimit. Po ashtu rezultoi se pas revokimit të kontratës e gjithë shuma 4.500.000 lekë është kthyer *cash* nga shoqëria ndërtimore me mandatarkëtimin⁵² nr. 6, datë 3.7.2012.

26.14 Lidhur me kredinë e përfituar në shumën 1.985.700 lekë, si një ndër burimet e krijimit të kësaj pasurie

26.14.i Nga praktika e kredisë rezultoi se me kontratën nr. *** rep., nr. *** kol., datë 12.6.2012, nënshkruar midis BKT-së, dega Vlorë, dhe kredimarrësit, bashkëshortit të subjektit E.H, është parashikuar përfitimi i saj në shumën 1.985.700 lekë, bazuar në ligjin nr. 9232/2004, “Për programet sociale të strehimit për banorët e zonave urbane”, i ndryshuar, VKM-ja nr. 600/2007 “Për trajtimin me strehim të nëpunësve civilë të administratës së lartë shtetërore dhe funksionarëve politikë”, udhëzimin nr. 6257/2008 “Mbi përcaktimin e masës së subvencionit për familjet që përfitojnë kredi të lehtësuara nga shteti”, si dhe udhëzimin e përbashkët të

⁵¹ Në vendimin nr. ***, paragrafi 10.21.

⁵² Depozituar me pyetësorin nr. 2, datë 13.9.2023.

Ministrisë së Punëve Publike, Transportit e Telekomunikacionit dhe Ministrisë së Financave nr. 10240/1, datë 17.10.2008 “Mbi përcaktimin e masës së subvencionit për familjet që përfitojnë kredi të lehtësuara nga shteti”, marrëveshjen tripalëshe datë 18.2.2009, etj.

26.14.ii Më tej, me kontratën e hipotekimit nr. ***, datë 12.6.2012, nënshkruar midis BKT-së, dega Vlorë, dhe hipotekuesve J. dhe A.LL (LI), është hipotekuar në favor të bankës si garanci për kredinë e aplikuar pasuria e tyre nr. ***, në z. k. ***, me sip. 73 m², me adresë lagjja “***”, p. ***, shk. ***, kati***, ap. ***.

26.14.iii Me Aneksin e Elementeve specifike të kredisë datë 12.6.2012 është përcaktuar se shuma e kredisë do të përdoret për likuidimin e vlerës së mbetur të çmimit të blerjes së apartamentit dhe se shuma e disbursuar do të transferohet nga llogaria e kredisë në favor të shitësit të objektit të kredituar shoqërisë “A.K” sh.p.k. me transfertë bankare nëpërmjet BKT-së.

26.14.iv Sipas praktikës bankare rezulton se kredia është disbursuar në favor të kredimarrësve në datën 26.6.2012, në shumën 1.985.700 lekë dhe në datën 27.6.2012 është kaluar në favor të shoqërisë ndërtime shuma 1.958.000 lekë, me përshkrimin “E.H kalon për blerje apartamenti”.

26.14.v Komisioni i kërkoi subjektit të rivlerësimit të jepte shpjegime lidhur me aplikimin dhe përfitimin e kësaj kredie në raport me legjislacionin e cituar më sipër. Subjekti në përgjigje ka sqaruar: *“Së pari, sipas informacionit të dhënë nga bashkëshorti, ai ka aplikuar për kredi të butë përpara martesës. Emri i tij është përfshirë në listën e familjeve përfituese sipas vendimit të Këshillit Bashkiak nr. ***, datë 24.11.2011. Nga përmbajtja e vendimit rezulton se është miratuar lista e 88 familjeve që janë skualifikuar nga BKT Vlorë dhe nuk mund të përfitojnë nga projekti i kredive të lehtësuara nga shteti. Gjithashtu rezulton se nga Këshilli Bashkiak është miratuar lista e 88 familjeve të reja që kanë aplikuar në Bashkinë Vlorë për të përfituar nga projekti i kredive të lehtësuara nga shteti sipas listës bashkëngjitur. Në listën bashkëlidhur vendimit nr. ***, datë 24.11.2022, të Këshillit Bashkiak, bashkëshorti rezulton të jetë i vetëm në certifikatën familjare (fakt i cili tregon se certifikata e ndodhur në dosjen e aplikimit, si dhe i gjithë dokumentacioni bashkëlidhur kërkesës për aplikim daton përpara martesë). Gjithashtu, në listën bashkëlidhur vendimit konstatohet se të ardhurat mujore janë 52.000 lekë (pra vetëm të bashkëshortit, çka tregon se ka qenë i vetëm në momentin e aplikimit të kredisë).*

Së dyti, bashkëshorti nga data 5.4.2010 deri në datën 7.2.2012 ka punuar pranë Bashkisë VI në pozicionin e drejtorit të marrëdhënieve me publikun. Duke qenë me këtë cilësi, bashkëshorti ka deklaruar se ka aplikuar për kredi në përputhje me pikën 1/e të VKM-së nr. 600, datë 12.9.2007 “Për trajtimin me strehim të nëpunësve civilë të administratës shtetërore dhe funksionarëve politikë” dhe sipas informacionit që më jepet prej tij, kredia është përfituar sipas kësaj cilësie. Në pikën 2 të VKM-së nr. 600, datë 12.9.2007 “Për trajtimin me strehim të nëpunësve civilë të administratës së lartë shtetërore dhe të funksionarëve politikë”, parashikohet se: “Të gjitha subjektet e përcaktuara në pikën 1 të këtij vendimi, gjatë kohës së ushtrimit të detyrës apo të funksionit shtetëror, të sipërpërmendur, kur kanë nevojë për strehim a sipërfaqe banimi shtesë, u lind e drejta të kërkojnë trajtim me kredi me kushte lehtësuese nga shteti për blerje banese apo sipërfaqe shtesë banimi, në vendin e ushtrimit të detyrës që, në kuptim të këtij vendimi, nënkupton territorin e rrethit, ku ndodhet selia administrative e organit, ku subjekti kryen funksionin a ushtron detyrën”. Qëllimi i miratimit të këtyre kredive, në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 600, datë 12.9.2007 “Për trajtimin me strehim të nëpunësve civilë të administratës së lartë shtetërore dhe funksionarëve publikë”, ka qenë mbështetja dhe ndihma financiare që synohej t’u jepej nëpunësve dhe funksionarëve publikë për të financuar blerjen e banesave në të cilat ata do të jetonin. Përfitimi nga kjo e drejtë, sipas VKM-së nr. 600, datë 12.9.2007, kushtëzohej me plotësimin e disa kushteve, në thelb të të cilave qëndron mospasja në pronësi prej nëpunësit/funksionarit publik dhe bashkëshortit/es të një banese tjetër apo të një sipërfaqeje banimi të standardizuar si të përshtatshme në vendin e

punës. Në kuptim të këtyre kushteve rezulton se bashkëshorti nuk ka pasur në pronësi në momentin e plotësimit të dokumentacionit në funksion të kësaj procedure, pasuri të tjera të cilat do ta vendosnin atë në kundërshtim me kushtet që parashikon VKM-ja nr. 600, datë 12.9.2007. Në këto kushte, vlerësoj se aplikimi dhe përfitimi i kësaj kredie prej bashkëshortit tim është në përputhje me legjislacionin në fuqi në kohën e aplikimit për arsye si më poshtë vijojnë: Së pari, bashkëshorti ka qenë subjekt përfitues në përputhje me nenin 1 të vendimit nr. 600, datë 12.9.2007, pasi në kohën e aplikimit dhe miratimit të kredisë ka qenë në cilësinë e drejtorit të marrëdhënieve me publikun. Së dyti, bashkëshorti nuk ka pasur në pronësi të tij të regjistruar asnjë pronë. Së treti, verifikimi i kushteve dhe kriterëve për marrjen e kësaj kredie është vlerësuar në dy nivele, fillimisht nga Këshilli Bashkiak dhe më pas nga BKT-ja, të cilat kishin kompetencën dhe detyrimin që të verifikonin plotësimin ose jo të kriterëve të parashikuara nga VKM-ja nr. 600/2007 përpara se të aprovonin kredinë në favor të bashkëshortit E.H”.

26.14.vi Në mbështetje të deklaratimit, subjekti ka depozituar vendimin nr. ***, datë 24.11.2011, të Këshillit Bashkiak Vlorë dhe shkresën nr. *** prot., datë 21.2.2013, të Entit Kombëtar të Banesave drejtuar Bashkisë Vlorë.

26.15 Komisionit, nisur nga faktet e konstatuara në vijim, nuk i rezultuan parregullsi në përfitimin e kësaj kredie, për sa kohë që nga dokumentacioni i administruar⁵³ gjatë hetimit administrativ, por edhe nga ai i depozituar nga subjekti në shpjegimet e dhëna, i rezultoi se:

- i) në emrat e qytetarëve që kanë përfituar kredi me kushte lehtësuese nga shteti renditet edhe emri i bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, z. E.H;
- ii) bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ka qenë subjekt përfitues në përputhje me nenin 1 të vendimit nr. 600, datë 12.9.2007, pasi në kohën e aplikimit dhe miratimit të kredisë ka qenë në cilësinë e drejtorit të marrëdhënieve me publikun;
- iii) bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit nuk ka pasur në pronësi të tij të regjistruar asnjë pronë në vendin e ushtrimit të detyrës.

26.16 Komisioni lidhur me këtë çështje hetoi edhe në lidhje me ekzistencën e ndonjë konflikti të mundshëm interesi midis subjektit të rivlerësimit, për shkak të ushtrimit të funksionit, dhe shoqërisë “A.K” sh.p.k., me administratore M.K. Nga korrespondenca e Komisionit me institucionet punëdhënëse, këto të fundit konfirmojnë⁵⁴ se subjekti i rivlerësimit nuk ka gjykuar çështje penale/civile/administrative me palë ndërgjyqëse shoqërinë “A.K” sh.p.k. apo administratoren M.K. Bazuar në dokumentacion e administruar, Komisioni konstatoi se subjekti nuk gjendet në kushtet e konfliktit të interesit.

27. Nga korrespondenca e Komisionit me institucionet publike⁵⁵ si AMF, Policia e Shtetit për hyrje-daljet, Ministria e Drejtësisë si administruese për regjistrin noterial, Komisionit nuk i kanë rezultuar problematika apo dyshime për përdorim automatësh, dalje në sistemin TIMS me mjete të padeklaruara apo kontrata të nënshkruara pranë noterit publik nga/dhe në adresë të subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortit të saj, përveçse atyre të identifikuar gjatë hetimit. Po ashtu, Komisionit përgjatë hetimit administrativ nuk i rezultuan prova apo indicie lidhur me pasuri të tjera të disponuara nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose bashkëshorti i saj z.E.H.

Konkluzion mbi vlerësimin e pasurisë

28. Në përfundim, trupi gjykues vlerëson se subjekti nuk ka në pronësi ose në përdorim pasuri më të mëdha nga sa mund të justifikojë ligjërisht. Nga hetimi administrativ i kryer dhe shqyrtimi i dokumentacionit rezultoi se subjekti i rivlerësimit në deklaratën *Vetting* ka deklaruar saktësisht dhe plotësisht pasuritë e saj, ashtu siç parashikohet në pikën 1 të nenit D

⁵³ Shkresë nr. *** prot., datë 7.11.2023, nga Bashkia Vlorë.

⁵⁴ Shkresë nr. *** prot., datë 15.9.2023, përcjellë nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër dhe shkresë nr. *** prot., datë 15.9.2023, përcjellë nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë.

⁵⁵ Shkresat: nr. *** prot., datë 29.03.2021, nga AMF-ja; nr. *** prot., datë 24.03.2021, nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit; si dhe nr. *** prot., datë 16.03.2021, nga Ministria e Drejtësisë.

të Aneksit të Kushtetutës. Në lidhje me problematikën e konstatuar në vlerësimin e kriterit të pasurisë, sipas arsyesimit dhe përfundimeve trajtuar në këtë vendim, trupi gjykues çmon se ato nuk janë të mjaftueshme që të sjellin aplikimin e pikës 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016. Trupi gjykues çmon se përgjatë procesit për këtë subjekt nuk identifikohen fakte e rrethana që cenojnë figurën e gjyqtarës dhe as besimin e publikut. Për sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit, znj. Gilda Hoxha, ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë sipas parashikimit të shkronjës “a” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.

B. KONTROLLI I FIGURËS

29. Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (AKSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjin nr. 84/2016. Për këtë qëllim, AKSIK-ja, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, ka dërguar raportin nr. *** prot., datë 27.10.2017, mbi kontrollin e figurës për subjektin e rivlerësimit, deklasifikuar plotësisht me vendimin nr. ***, datë 11.7.2023, të KDZH-së, ku në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera, në përputhje me pikën 2 të nenit 39 të ligjit nr. 84/2016, AKSIK-ja ka konstatuar: *Përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit Gilda Hoxha.*

Hetimi i Komisionit

29.1 Komisioni, në vijim, si organi i legjitimuar nga Kushtetuta dhe ligji nr. 84/2016 për të bërë rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, ka hetuar në mënyrë të pavarur çdo informacion dhe konkluzion të institucionit të lartpërmendur, ashtu sikurse të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016.

29.2 Me informacionin e përditësuar⁵⁶ të raportit nr. *** prot., datë 27.10.2017, AKSIK-ja informon se nuk ka të dhëna të tjera lidhur me raportin e kontrollit të figurës së vitit 2017.

29.3 Nga hetimi administrativ i kryer nuk u gjetën elemente që të vërtetojnë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar apo përfshirjen e subjektit në veprimtari të kundërligjshme, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës.

29.4 Për sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit Gilda Hoxha ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të shkronjës “b” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.

C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

30. Raporti i vlerësimit të aftësive profesionale është përgatitur nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, si organi ndihmës për vlerësimin profesional, që kryhet nga institucionet e rivlerësimit në procesin e rivlerësimit kalimtar të subjekteve të rivlerësimit bazuar në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

30.1 Raporti është hartuar bazuar në përshkrimin dhe analizimin e: (i) formularit të vetëdeklarimit, të 3 dokumenteve ligjore të llojit vendim gjyqësor⁵⁷ të përzgjedhura nga

⁵⁶ Me shkresën nr. *** prot., datë 3.8.2023 dhe nr. *** prot., datë 10.7.2023, të AKSIK-së, administruar në dosjen e Komisionit.

⁵⁷ Vendimi civil nr. ***, datë 19.2.2015, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër, që i përket paditësit T.T kundër të paditurit *** sh.a., me objekt “Deklarimin e pavlefshëm të zgjidhjes së kontratës së punës dhe shpërblim dëmi”; (ii) vendimi penal nr. ***, datë 18.2.2015, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër, që i përket Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Dibër kundër të pandehurit G.K, i akuzuar për veprat penale “Dhuna në familje” dhe “Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe municionit”;

subjekti i rivlerësimit, si dhe të dhënave e dokumenteve të tjera që shoqërojnë formularin e vetëdeklarimit dhe që janë paraqitur nga subjekti i rivlerësimit; (ii) 5 dosjeve gjyqësore⁵⁸ të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor; (iii) të dhënave nga burimet arkivore të KLD-së.

30.2 Raporti ka përshkruar dhe analizuar dokumentet e vlerësimit profesional të subjektit Gilda Hoxha, gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër. Në raport janë analizuar të dhënat e rezultuara nga dokumentet, duke iu referuar kriterëve të vlerësimit: aftësive profesionale; aftësive organizative; etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale; aftësive personale dhe angazhimit profesional. Koha e përgatitjes së këtij raporti është periudha 8.10.2013 – 8.10.2016.

Analiza e gjetjeve

31. Aftësitë profesionale

a) Njohuritë ligjore

31.1 Subjekti i rivlerësimit Gilda Hoxha ka përfunduar Shkollën e Magjistraturës dhe periudha e rivlerësimit përkon me fillimin e detyrës prej saj. Në 3 dokumentet ligjore dhe në 5 dosjet e vëzhguara është konstatuar se subjekti i rivlerësimit Gilda Hoxha në përgjithësi identifikon normën ligjore të zbatueshme në funksion të zgjidhjes së çështjes gjyqësore. Analizon normën në raport me rrethanat konkrete të mosmarrëveshjes dhe nxjerr konkluzione mbi çështjen nga zbatimi i saj.

31.2 Ajo ka njohuri për procedurën e gjykimit. Ajo merr në analizë kryesisht juridiksinin gjyqësor, kompetencën lëndore dhe tokësore. Identifikon rastet kur për sqarimin e fakteve dhe rrethanave që kanë lidhje me mosmarrëveshjen duhen njohuri të posaçme, duke thirrur ekspertë të fushës dhe tregon kujdesin e duhur për të saktësuar pyetje shtruese për ekspertin, duke i pasqyruar ato edhe në vendimin e arsyetuar për kryerjen e ekspertimit si akt.

31.3 Në disa raste, ajo shpjegon në vendim koncepte kyçe që përmban norma ligjore e përdorur për zgjidhjen e mosmarrëveshjes dhe përdor në mënyrë të shprehur parimet e përgjithshme të së drejtës. Ndërsa, lidhur me jurisprudencën e gjykatave më të larta nuk mund të nxirret përfundim mbi nivelin e njohurive të saj, pasi përdorimi i tyre prej gjyqtarës Gilda Hoxha është i kufizuar vetëm për institutin e gjykimit të shkurtuar, ku ajo i përdor referencat – vendimin nr. 2/2003 të Gjykatës së Lartë dhe vendimin nr. 4/2012 të Gjykatës Kushtetuese. Tri dokumentet e përzgjedhura dhe pesë dosjet gjyqësore konfirmojnë njohuritë e saj mbi të drejtën e shpërblimit nga zgjidhja e marrëdhënieve të punës, mbi përgjegjësinë penale për veprat penale “Dhuna në familje”, “Mbajtja pa leje e armëve luftarake”, “Falsifikimi i dokumenteve

(iii) vendimi penal nr. ***, datë 11.11.2015, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër, që i përket Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Dibër kundër të pandehurit SH.B, i akuzuar për veprën penale “Falsifikimi i dokumenteve shkollore”.

⁵⁸ Dosja 1 – Çështja penale nr. *** regjistri themeltar, datë 22.9.2015 regjistrimi, që i përket Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Dibër kundër të pandehurit T.SH, i akuzuar për veprën penale “Drejtimi i automjetit në gjendje të dehur apo pa dëshmi”, të parashikuar nga neni 291 i Kodit Penal, e përfunduar me vendimin nr. ***, datë 12.11.2015. Dosja 2 – Çështja penale nr. *** regjistri themeltar, datë 7.10.2015 regjistrimi, që i përket Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Dibër kundër të pandehurit P.SH, i akuzuar për veprën penale “Plagosje e lehtë me dashje”, parashikuar nga neni 89 i Kodit Penal, e përfunduar me vendimin nr. ***, datë 7.1.2016. Dosja 3 – Çështja civile nr. *** regj. them., datë 16.4.2014 regjistrimi, që i përket kërkuesit H.L dhe personit të tretë AKKP Tiranë, me objekt “Rivendosje në afat të kërkesës për t’iu drejtuar AKKP-së”, e përfunduar me vendimin nr. ***, datë 22.5.2014. Dosja 4 – Çështja civile nr. *** regj. them., datë 25.9.2016 regjistrimi, që i përket paditësit A.M kundër të paditurës E.M dhe personit të tretë Zyra e Gjendjes Civile T., me objekt “Kundërshtim atësie të prezumuar të fëmijës dhe fshirjen e të dhënave në regjistrat e gjendjes civile”, e përfunduar me vendimin nr. ***, datë 21.7.2016. Dosja 5 – Çështja civile nr. *** regj. them, datë 16.7.2014, që i përket paditëses E.XH kundër të paditurit drejtoria e shkollës 9-vjeçare “****”, si dhe personit të tretë DAR Qarku ***, me objekt “Pavlefshmëri pjesërisht e fletës nr. *** të amzës së shkollës për sa i takon datëlindjes (data dhe muaji) dhe korrigjimin e gabimit”, e përfunduar me vendimin nr. ***, datë 30.10.2014.

shkollorë”, “Drejtimi i mjetit në mënyrë të parregullt”, “Plagosje e lehtë me dashje”, si dhe në çështjet civile me objekt “Kundërshtimi i atësisë”, apo “Korrigjimi i akteve zyrtare”.

31.4 Nga 3 dokumentet e përzgjedhura nga subjekti dhe 5 dosjet e vëzhguara rezulton se në tri raste nuk ka pasur ankim nga palët. Në 5 raste të tjera të ankimuara konstatohet se 3 vendime janë lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit, për 1 vendim është vendosur mospranimi i ankimit nga Gjykata e Apelit dhe 1 vendim është prishur dhe çështja penale është pushuar për shkak të dhënies së amnistisë me ligj, të miratuar nga Kuvendi pas dhënies së vendimit në shkallë të parë nga gjyqtarja Gilda Hoxha.

31.5 Sipas të dhënave nga burimet arkivore të KLD-së evidentohet se ndaj gjyqtarës Gilda Hoxha përgjatë periudhës së rivlerësimit janë paraqitur 2 ankesa në Inspektoratin e KLD-së. Nga shqyrtimi administrativ i tyre 1 ankesë i është regjistruar për vlerësim profesional, pasi gjyqtarja nuk ka marrë në shqyrtim brenda afatit ligjor kërkesën për sigurimin e padisë në procesin civil.

b) Arsyetimi ligjor

31.6 Vendimet gjyqësore të hartuara prej subjektit të rivlerësimit Gilda Hoxha përgjithësisht janë të qarta, të plota dhe të kuptueshme. Struktura e vendimeve përfundimtare është organizuar sipas kërkesave të legjislacionit procedural dhe e standardizuar. Për shkak të standardizimit, ajo bën pjesë të arsyetimit të vendimit edhe çështje procedurale mbi juridiksionin gjyqësor, kompetencat lëndore e tokësore dhe gjykimin e shkurtuar. Ajo respekton rregullat e drejtshkrimit dhe përdor të gjitha karakteret e gjuhës shqipe në funksion të qartësisë së arsyetimit të vendimit gjyqësor.

31.7 Pjesa hyrëse e vendimit hartohet prej saj në mënyrë të plotë dhe përmban të gjitha elementet e kërkuara nga ligji. Pjesa arsyetuese hartohet prej saj e ndarë në nënpjesë të dedikuara veçmas për faktin dhe veçmas për analizën ligjore. Arsyetimi i vendimeve është gjithëpërfshirës në raport me pretendimet e palëve. Në tekstet e vendimit ekziston lidhja midis fakteve dhe konkluzioneve që ka arritur gjyqtari. Një tipar shumë i mirë i saj është analiza e plotë e individualizimit të llojit dhe masës së dënimit, ku u kushton rëndësi të gjithë faktorëve prezent të rastit penal. Ajo ka prirjen të shpjegojë konceptet kyçe të normës materiale që zbaton në rastin konkret, duke përdorur metoda të ndryshme interpretimi. Përgjithësisht, në arsyetimin e vendimit fokusohet tek thelbi i çështjes dhe konkretizimi i tij sipas rastit në mosmarrëveshje, por nuk i shmanget përdorimit të fjalive të përgjithshme apo arsyetimit të tepërt mbi çështje të konsoliduara nga praktika dhe doktrina, si arsyetimi për juridiksionin, kompetencën dhe legjitimin e palëve, ndonëse ato nuk janë kundërshtuar nga palët. Dispozitivi i vendimit hartohet prej saj në mënyrë të plotë dhe përmban edhe disponimet dytësore, që kanë rëndësi për zbatimin e vendimit.

31.8 Në 5 dosjet e vëzhguara është konstatuar se në përgjithësi ajo i kushton rëndësinë e duhur arsyetimit të vendimeve të ndërmjetme, duke i dhënë pas marrjes së mendimit të palëve dhe duke i referuar edhe në dispozitën ligjore.

32. Aftësitë organizative

a) Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë

32.1 Subjekti i rivlerësimit Gilda Hoxha në periudhën e rivlerësimit 8.10.2013 – 8.10.2016 ka kryer detyrën e gjyqtarës së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër, duke filluar nga data 23.1.2014. Ajo ka deklaruar se i janë caktuar për gjykim 1100 çështje, të cilat i ka përfunduar të gjitha. Në datën 26.9.2016, ajo është shkëputur nga detyra për shkak të lejes së barrë lindjes. Rendimenti i përfundimit të çështjeve bazuar në këto të dhëna është 100%.

32.2 Nga të dhënat statistikore të përcjella nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Dibër, për efekt të organizimit të shortit, konstatohet se për periudhën e rivlerësimit 8.10.2013 – 8.10.2016 gjyqtarja Gilda Hoxha ka përfunduar gjithsej 1102 çështje gjyqësore, nga të cilat 545 çështje

penale (298 penale themeli, krime dhe kundërvajtje penale, 157 masa sigurimi dhe 90 të veçanta penale), 213 civile të përgjithshme themeli, 111 familjare, 29 urdhra mbrojtjeje dhe 204 urdhra ekzekutimi.

32.3 Sipas pikës 3, shkronja “g” e Aneksit 1 të Sistemit të Vlerësimit, në aspektin sasior, gjyqtari i gjykatës së shkallës së parë, që nuk është i organizuar në seksione, duhet të jetë në cilësinë e relatorit në jo më pak se 200 çështje penale (krime dhe kundërvajtje penale) dhe civile që kanë të bëjnë me mosmarrëveshje mes palëve kundërshtare. Ky rregull, në rastin e gjyqtarës Gilda Hoxha, nënkupton të paktën 553 çështje penale dhe civile për 2 vjet e 9 muaj, që është periudha e saj e rivlerësimit. Duke e zbatuar këtë rregull në raport me të dhënat statistikore të saj konstatohet se ngarkesa sasiore ka qenë në standardin sasior.

32.4 Nga analiza e 5 dosjeve të përzgjedhura me short konstatohet se katër çështje janë gjykuar nga gjyqtarja Gilda Hoxha brenda afateve standarde të Sistemit të Vlerësimit, ndërsa një çështje jashtë këtij afati. Këto çështje janë gjykuar konkretisht në intervale kohore 20 ditë, 3 muaj, 1 muaj e 6 ditë, 9 muaj e 26 ditë dhe tre muaj e 14 ditë. Çështja që ka pasur kohëzgjatjen më të lartë të gjykimit prej 9 muaj e 26 ditë ka qenë çështje civile, e shqyrtuar në 15 seanca gjyqësore, ku shkak është bërë sjellja e palëve në proces. Megjithatë edhe natyra e çështjes ka qenë komplekse, pasi ishte i domosdoshëm ekspertimi i ADN-së. Në përfundim të kësaj çështjeje, gjyqtarja ka disponuar me vendim për pranimin e kërkesëpadisë dhe vendimi i saj është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Tiranë.

32.5 Kohëzgjatja e gjykimit është analizuar edhe tek 3 dokumentet ligjore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, ku konstatohet se ato kanë zgjatur 1 muaj e 12 ditë, 1 muaj e 9 ditë dhe 29 ditë. Në të tria këto raste, gjykimi ka përfunduar brenda afateve standarde të Sistemit të Vlerësimit. Lidhur me kohën mesatare të arsytimit të vendimeve gjyqësore, si datë e arsytimit të vendimit është vlerësuar data e dorëzimit të dosjes gjyqësore në sekretari, si e vetmja e dhënë objektive. Nga vëzhgimi i 5 dosjeve të shortuara është konstatuar se gjyqtarja Gilda Hoxha nuk i ka arsyetuar në çdo rast brenda afateve ligjore vendimet e saj, por vonesat kanë qenë disaditore dhe, gjithsesi, brenda afatit të ankimit në Gjykatën e Apelit.

32.6 Së fundmi, duke konsideruar të dhënat e mësipërme, konstatohet se gjyqtarja Gilda Hoxha ka aftësi për të përballuar ngarkesën në punë.

c) Aftësia për të kryer procedurat gjyqësore

32.7 Subjekti i rivlerësimit Gilda Hoxha merr masat për planifikimin dhe organizimin e veprimeve të nevojshme dhe përgatitjen e çështjeve për gjykim, me qëllim përfundimin në kohë të tyre. Dosjet e vëzhguara janë vënë në lëvizje pa vonesa prej saj, përmes vendimeve formale për caktimin e seancës gjyqësore.

32.8 Në të 5 dosjet e vëzhguara, seancat janë zhvilluar në sallë gjykimi dhe janë dokumentuar me regjistrim audio, në funksion të transparencës dhe solemnitetit në gjykim. Ajo përgjithësisht respekton orarin e fillimit të seancës.

32.9 Gjatë gjykimit, ajo identifikon veprimet procedurale që duhen kryer dhe nxjerr urdhra dhe vendime të ndërmjetme të arsyetuara për realizimin e tyre. Përgjithësisht zhvillon në mënyrë korrekte procedurën e gjykimit gjatë drejtimit të procesit gjyqësor, duke ndjekur hapat që lidhen me çeljen e seancës, verifikimin e palëve, si dhe për prezantimin e gjykatës. Orienton drejt debatin gjyqësor, kërkimet e palëve gjer në dhënien e vendimit përfundimtar.

d) Aftësia për të administruar dosjet

32.10 Nga vëzhgimi i 5 dosjeve gjyqësore të përzgjedhura me short u konstatua se ato kanë qenë të rregullta, të sakta dhe të plota. Në dosjen penale të themelit ndodhet vendimi i subjektit të rivlerësimit për caktimin e seancës gjyqësore, fleta e informacionit mbi çështjen, fashikulli i hetimit, aktet e njoftimit, aktet e hetimit paraprak të bashkuara me fashikullin e gjykimit për shkak të gjykimit të shkurtuar, procesverbali gjyqësor, konkluzionet përfundimtare të

prokurorit dhe vendimi gjyqësor. Procesverbali i seancës gjyqësore është i plotë, me të gjitha të dhënat dhe përshkrimet për veprimet procedurale të kryera dhe i nënshkruar rregullisht prej sekretares gjyqësore dhe gjyqtarit, konform kërkesave të neneve 345 dhe 346 të Kodit të Procedurës Penale.

32.11 Në dosjet civile ndodhet vendimi i subjektit të rivlerësimit për caktimin e seancës përgatitore, fleta e informacionit mbi çështjen, kërkesëpadia dhe aktet, aktet e njoftimit, procesverbalet gjyqësore, konkluzionet e palëve dhe vendimi gjyqësor. Procesverbali gjyqësor përgjithësisht është i plotë, me të gjitha të dhënat dhe përshkrimet për veprimet procedurale të kryera dhe i nënshkruar rregullisht prej sekretares gjyqësore dhe gjyqtarit konform kërkesave të nenit 118 të Kodit të Procedurës Civile.

32.12 Në fashikullin e gjykimit përfshihen vendimet gjyqësore dhe dëftesat e komunikimit të vendimeve për palët në mungesë, si dhe vendimi për lëshimin e urdhrave të ekzekutimit.

32.13 Aktet në të gjitha dosjet janë sistemuar në mënyrë kronologjike në referencë të rregullave procedurale civile, duke u bërë lehtësisht të shfrytëzueshme për palët. Çdo dosje gjyqësore është e inventarizuar rregullisht.

33. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale

a) Etika në punë

33.1 Gjyqtarja Gilda Hoxha ka marrë titullin “Jurist” nga Universiteti i Tiranës në datën 30.6.2006 dhe titullin “Magjistrat gjyqtar” nga Shkolla e Magjistraturës në vitin 2011. Pas studimeve, në datën 23.1.2014, ajo është emëruar gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Dibër, ku vazhdon edhe aktualisht.

33.2 Nga ana tjetër, për gjyqtaren Gilda Hoxha përgjatë periudhës së rivlerësimit nuk është regjistruar asnjë kërkesë për procedim dhe nuk është dhënë asnjë masë disiplinore. Edhe nga vëzhgimi i 5 dosjeve nuk rezultuan të dhëna negative për këtë aspekt.

b) Integriteti

33.3 Nga të dhënat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit Gilda Hoxha dhe nga 5 dosjet e vëzhguara konstatohet se nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me imunitetin e saj ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm.

c) Paanësia

33.4 Nga 3 dokumentet ligjore të paraqitura nga vetë subjekti dhe nga 5 dosjet e vëzhguara nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit Gilda Hoxha. Në 5 dosjet e vëzhguara nuk ka pasur kërkesa për përjashtimin e saj nga gjykimi i çështjeve, si dhe nuk është konstatuar përdorim i gjuhës diskriminuese apo elemente të tjera që të vënë në dyshim paanësinë e subjektit të rivlerësimit. Ajo ka shqyrtuar 2 çështje që lidhen me grupet vulnerabël: në një rast ka shqyrtuar akuzën penale “Dhuna në familje” dhe në një rast ka shqyrtuar mosmarrëveshjen për atësinë e një fëmije të mitur. Në të dyja këto raste, gjyqtarja Gilda Hoxha i ka kushtuar rëndësi zgjidhjes në themel të çështjes. Po ashtu, nuk janë konstatuar raste që subjekti i rivlerësimit Gilda Hoxha nuk ka respektuar rregullat procedurale me pasojë cenimin e standardit të gjykatës së paanshme.

34. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional

a) Aftësitë e komunikimit

34.1 Në 5 dosjet gjyqësore të vëzhguara, në procesverbalin gjyqësor është konstatuar se gjyqtarja Gilda Hoxha komunikon me etikë me palët në seancat gjyqësore. Ajo ka aftësi komunikuese me palët, ku shfaq sjellje etike, duke ruajtur paanësinë në gjykim dhe respektuar barazinë e palëve. Në 3 dokumentet ligjore dhe në 5 dosjet e vëzhguara gjuha e përdorur në akte është normale, komunikimi në përputhje me etikën gjyqësore dhe i qartë.

b) Aftësia për të bashkëpunuar

34.2 Në 3 dokumentet ligjore dhe në 5 dosjet e vëzhguara nuk janë konstatuar të dhëna specifike mbi aftësinë e subjektit Gilda Hoxha për të bashkëpunuar me kolegët dhe administratën gjyqësore, si dhe nëse subjekti ka shkëmbyer njohuri apo përvojë profesionale me ta. Në 5 çështje gjyqësore të vëzhguara ajo ka qenë gjyqtare e vetme për gjykimin e çështjes dhe është konstatuar se ka bashkëpunuar me administratën gjyqësore për të zhvilluar seancën sipas rregullave procedurale penale, duke respektuar afatet dhe duke dokumentuar rregullisht veprimet. Në 5 dosjet e vëzhguara nuk është identifikuar vonesë domethënëse në fillimin e seancave gjyqësore apo në depozitimimin e dosjes me vendimin e arsyetuar në sekretari.

c) Gatishmëria për t'u angazhuar

34.3 Subjekti i rivlerësimit Gilda Hoxha, pas përfundimit të Fakultetit të Drejtësisë dhe Shkollës së Magjistraturës, ka ushtruar funksionin e gjyqtares së shkallës së parë. Për shkak të funksionit, ajo i nënshtrohet detyrimisht programit të formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës. Në periudhën e rivlerësimit ajo ka marrë pjesë në 11 seminare të organizuara nga Shkolla e Magjistraturës. Të dhënat tregojnë se ajo ka marrë pjesë në 20 ditë të formimit vazhdues për periudhën e rivlerësimit. Lënda e trajnimeve ku ajo ka marrë pjesë ka një lidhje të arsyeshme me detyrën e gjyqtarit të shkallës së parë, të paorganizuar në seksione dhe dhoma. Nuk ka të dhëna të dokumentuara që gjyqtarja Gilda Hoxha të jetë angazhuar në aktivitete të tjera profesionale.

Raporti ka përshkruar të dhënat nga burimet arkivore të KLD-së

35. Nga analiza e të dhënave në dosjen personale konstatohet se gjyqtarja Gilda Hoxha ka marrë titullin “Jurist” nga Universiteti i Tiranës në datën 30.6.2006 dhe titullin “Magjistrat gjyqtar” nga Shkolla e Magjistraturës në vitin 2011. Pas studimeve, në datën 23.1.2014, ajo është emëruar gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Dibër, ku vazhdon edhe aktualisht.

36. Sipas të dhënave nga regjistri i ankesave rezulton se gjatë periudhës trevjeçare të rivlerësimit 8 tetor 2013 – 8 tetor 2016, për gjyqtaren Gilda Hoxha janë paraqitur gjithsej dy ankesa (në vitin 2016)⁵⁹ në Inspektoratin e KLD-së.

37. Sipas të dhënave të regjistrimit të procedimeve disiplinore, për gjyqtaren Gilda Hoxha përgjatë periudhës së rivlerësimit nuk është regjistruar asnjë kërkesë për procedim dhe nuk është dhënë asnjë masë disiplinore.

C/1. Rivlerësimi profesional

38. Komisioni, pasi u njoh dhe analizoi dokumentacionin e depozituar nga KLGJ-ja, mbi të cilin është hartuar raporti i Vlerësimit Profesional për këtë subjekt rivlerësimi, sa i përket tri dokumenteve⁶⁰ të vëna në dispozicion nga subjekti, nuk konstatoi shkelje procedurale.

38.1 Konstatoi se për dy vendimet gjyqësore të subjektit, përkatësisht nr. ***, datë 19.2.2015, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër, që i përket paditësit T.T kundër të paditurit *** sh.a., me objekt “Deklarimi i pavlefshëm i zgjidhjes së kontratës së punës dhe shpërblim dëmi” dhe nr. 309(33-2015-1079), datë 11.11.2015, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër, që i përket Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Dibër kundër të pandehurit SH.B, i akuzuar për veprën penale “Falsifikimi i dokumenteve shkollore”, është ushtruar e drejta e ankimit dhe Gjykata e Apelit ka lënë në fuqi vendimet e dhëna të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër.

⁵⁹ trajtuar te rubrika “Rivlerësimi profesional”.

⁶⁰ (i) Vendimi civil nr. ***, datë 19.2.2015, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër, që i përket paditësit T.T kundër të paditurit *** sh.a., me objekt “Deklarimi i pavlefshëm i zgjidhjes së kontratës së punës dhe shpërblim dëmi”; (ii) vendimi penal nr. ***, datë 18.2.2015, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër, që i përket Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Dibër kundër të pandehurit G.K, i akuzuar për veprat penale “Dhuna në familje” dhe “Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe municionit”; (iii) vendimi penal nr. ***, datë 11.11.2015, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër, që i përket Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Dibër kundër të pandehurit SH.B, i akuzuar për veprën penale “Falsifikimi i dokumenteve shkollore”.

38.2 Për sa i përket vendimit penal nr. ***, datë 18.2.2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër, që i përket Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Dibër kundër të pandehurit G.K, i akuzuar për veprën penale “Dhuna në familje”, Gjykata e Apelit ka vendosur mospranimin e ankimit ndaj vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër.

38.3 Në lidhje me 5 dosjet⁶¹ e shortuara nëpërmjet një sistemi rastësor, për të cilat është konkluduar në raportin e KLGJ-së, Komisioni, nga verifikimi përkatës, ashtu sikurse ka konkluduar edhe raporti i vlerësimit profesional, konstatoi se:

38.4 Për tri vendime të dhëna nga subjekti i rivlerësimit (që i përkasin dosjeve 1, 3 dhe 5) nuk është ushtruar e drejta e ankimit nga palët. Për vendimin nr. ***, datë 7.1.2016, është ushtruar e drejta e ankimit dhe Gjykata e Apelit Tiranë me vendimin nr. ***, datë 7.6.2017, ka vendosur prishjen e vendimit nr. ***, datë 7.1.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër dhe pushimin e çështjes. Arsyeja e cenimit lidhet me dhënien e amnistisë për veprën penale me ligjin nr. 141/2016⁶², datë 22.12.2016, pra pas dhënies së vendimit në shkallë të parë nga gjyqtarja Gilda Hoxha. Vendimi nr. ***, datë 21.7.2016, është ankimuar dhe Gjykata e Apelit ka vendosur lënien në fuqi të këtij vendimi.

38.5 Në të tria dokumentet e dorëzuara nga subjekti dhe në pesë dosjet e shortuara tregohet në dispozitivin e vendimit se kujt i ngarkohen shpenzimet gjyqësore dhe, po ashtu, tregohet e drejta e afatit të ankimit për palët ndërgjyqëse. Vendimet duken të strukturuar dhe standardizuara, me tekst të qartë, të argumentuar dhe pa gabime. Rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka dhënë vendime të ndërmjetme sipas procedurës ligjore.

38.6 Përgjithësisht, nga verifikimi i kohëzgjatjes së gjykimeve të çështjeve dhe dorëzimit të vendimeve të arsyetuara nga subjekti i rivlerësimit nuk vërehen problematika.

39. Ankesat

39.1 Sipas të dhënave nga regjistri i ankesave rezulton se gjatë periudhës trevjeçare të rivlerësimit “8 tetor 2013 – 8 tetor 2016”, për gjyqtaren Gilda Hoxha janë paraqitur gjithsej 2 ankesa (në vitin 2016) në Inspektoratin e KLD-së. Një ankesë është arkivuar pas shqyrtimit fillestar me arsyetimin se është ankesë e përsëritur më parë, ndërsa 1 ankesë është verifikuar për mosrespektim formal ligji dhe është konstatuar se gjyqtarja nuk ka shqyrtuar kërkesën për sigurim padie në një çështje civile brenda afatit ligjor, duke iu regjistruar kjo ankesë për vlerësim profesional dhe etik.

39.2 Për sa më sipër, lidhur me ankesën e verifikuar për mosrespektim formal të ligjit, nga ku është konstatuar se gjyqtarja nuk ka shqyrtuar kërkesën për sigurim padie në një çështje civile brenda afatit ligjor, duke iu regjistruar kjo ankesë për vlerësim profesional dhe etik, Komisioni i kërkoi subjektit të shpjegojë dhe dokumentojë të kundërtën e konstatimit.

⁶¹ Dosja 1 – Çështja penale nr. *** regjistri themeltar, datë 22.9.2015 regjistrimi, që i përket Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Dibër kundër të pandehurit T.SH, i akuzuar për veprën penale “Drejtim i automjetit në gjendje të dehur apo pa dëshmi” të parashikuar nga neni 291 i Kodit Penal, e përfunduar me vendimin nr. ***, datë 12.11.2015. Dosja 2 – Çështja penale nr. *** regjistri themeltar, datë 7.10.2015 regjistrimi, që i përket Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Dibër kundër të pandehurit P.SH, i akuzuar për veprën penale “Plagosje e lehtë me dashje”, parashikuar nga neni 89 i Kodit Penal, e përfunduar me vendimin nr. ***, datë 7.1.2016. Dosja 3 – Çështja civile nr. *** regj. them., datë 16.4.2014 regjistrimi, që i përket kërkuarit H.L dhe personit të tretë AKKP Tiranë, me objekt “Rivendosje në afat të kërkesës për t’iu drejtuar AKKP-së”, e përfunduar me vendimin nr. ***, datë 22.5.2014. Dosja 4 – Çështja civile nr. *** regj. them., datë 25.9.2016 regjistrimi, që i përket paditësit A.M kundër të paditurës E.M dhe personit të tretë Zyra e Gjendjes Civile T, me objekt “Kundërshtim atësie të prezumuar të fëmijës dhe fshirjen e të dhënave në regjistrat e gjendjes civile”, e përfunduar me vendimin nr. ***, datë 21.7.2016. Dosja 5 – Çështja civile nr. *** regj. them., datë 16.7.2014, që i përket paditëses E.XH kundër të paditurit drejtoria e shkollës 9-vjeçare “***”, si dhe personit të tretë DAR Qarku ***, me objekt “Pavlefshmëri pjesërisht e fletës nr. *** të amzës së shkollës për sa i takon datëlindjes (data dhe muaji) dhe korrigjimin e gabimit”, e përfunduar me vendimin nr. ***, datë 30.10.2014.

⁶² Ligji nr. 141/2016, neni 3/Kriteret për përfitimin e amnistisë: “1. Amnistohen personat e dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë, me burgim deri në 3 vjet ose çdo lloj dënimi tjetër më të butë, duke përfshirë gjobën, pezullimin e dënimit me burgim ose çdo lloj dënimi tjetër alternativ për dënime të dhëna deri në datën 25.12.2016, pavarësisht nga koha e mbetur nga dënimi”.

Subjekti, në shpjegimet e saj⁶³ ka deklaruar se pasi i janë vënë në dispozicion praktikat në datën 19.10.2023, ka vërejtur se të dyja ankesat janë regjistruar ndaj saj dhe i përkasin shtetasit SH.B për të njëjtën çështje. Subjekti ka deklaruar se lidhur me ankesën, e cila është verifikuar për mosrespektim formal të ligjit, është konstatuar se nuk ka shqyrtuar kërkesën për sigurim padie në një çështje civile brenda afatit ligjor (duke u regjistruar kjo ankesë për vlerësim profesional dhe etik).

39.2.i Paraprakisht, subjekti ka theksuar se me këtë sugjerim për regjistrimin e ankesës për vlerësim profesional dhe etik nga ana e Inspektoratit të KLD-së është njohur për herë të parë në datën 19.10.2023, kur ka marrë praktikën e kërkuar nga KLGJ-ja, pasi para këtij momenti, nga ana e organit që ka shqyrtuar ankesën nuk i është komunikuar asnjëherë ky akt/veprim administrativ. Ky fakt, ka deklaruar subjekti, rezulton tërësisht i provuar edhe nga praktika e administruar⁶⁴, ku nga shkresa me nr. *** prot., datë 14.6.2017, me objekt “Kthim përgjigjeje” (në të cilën i pasqyrohet për dijeni gjyqtares Gilda Hoxha) nuk rezulton që ky njoftim të jetë kryer. Pra, ky njoftim/shkresë, ka deklaruar ajo, nuk ka mbërritur asnjëherë te subjekti.

39.2.ii Subjekti e ka konsideruar këtë sugjerim tërësisht të pabazuar në ligj si në aspektin procedural ashtu edhe në atë të përmbajtjes.

39.2.iii Subjekti ka deklaruar se ky sugjerim për t’u mbajtur parasysh për efekt të vlerësimit profesional të Inspektoratit të KLD-së bazohet në nenin 34 të rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë”⁶⁵, aktualisht e shfuqizuar⁶⁶. Ky parashikim i rregullores, i cili është shfuqizuar më pas nga vetë KLD-ja⁶⁷, përbënte një parashikim tërësisht në kundërshtim me parashikimet e nenit 14, pika 1 e ligjit nr. 8811/2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë” (ligji në bazë dhe për zbatim të të cilit ka dalë kjo rregullore), pasi del tërësisht jashtë fushës së veprimtarisë që duhet të rregullonte ky akt, që konsistonin në organizimin, funksionimin dhe numrin e inspektorëve të Inspektoratit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë. Subjekti ka vijuar të sqarojë veprimet në kundërshtim me ligjin në rastin e konsiderimit të ankesës për vlerësim, në raport me kompetencat ekskluzive vetëm të Këshillit të Lartë të Drejtësisë për të disponuar mbi masat që ndikojnë në vlerësimin apo ecurinë e karrierës së gjyqtarit. Subjekti ka shtuar se kompetenca që ka ushtruar Kryeinspektori duke sugjeruar që shkelja ligjore e konsumuar për shkak të mosrespektimit të afatit 5-ditor për shqyrtimin e sigurimit të padisë, në rastin konkret, nëpërmjet një akti apo veprimi administrativ të hartuar tërësisht jashtë kompetencave të tij, ka cenuar kuadrin ligjor dhe kushtetues në fuqi, në kohën e kryerjes së këtij disponimi. Subjekti ka depozituar dy *qëndrime të praktikës gjyqësore lidhur me raste të ngjashme, me anë të së cilave është konstatuar paligjshmëria dhe pavlefshmëria e akteve/veprimeve administrative të kësaj natyre (vendim nr. ***, datë 10.2.2020 dhe vendim nr. ***, datë 24.2.2021, të Gjykatës Administrative të Apelit*⁶⁸). Subjekti ka kundërshtuar veprimtarinë e inspektorëve si të pambështetur në aktet e dosjes gjyqësore që kanë administruar dhe shqyrtuar gjatë verifikimit

⁶³ Përcjellë me email në datën 23.10.2023.

⁶⁴ “Nga praktika e administruar rezulton se në datën 15.9.2016 jam njohur me aktinjoftimin për urdhrin e verifikimit të ankesës, por kurrësi me rezultatet në përfundim të këtij verifikimi”.

⁶⁵ Miratuar me vendimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë nr. 195/a/a, datë 5.7.2006, shtuar dhe ndryshuar me vendimet nr. 207/1, datë 7.2.2007 dhe nr. 55, datë 28.5.2014, të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, aktualisht e shfuqizuar për shkak të hyrjes në fuqi të ligjit nr. 115/2016.

⁶⁶ Ku parashikohej se: “2. Nëse çmohet se rasti i verifikuar është i pamjaftueshëm apo ajo shkelje e konstatuar nuk është thelbësisht e tillë që mund të iniciohet përshtatshëm një procedim disiplinor, gjyqtarit konkret i tërhiqet vëmendja me shkrim, duke u bërë ajo pjesë përbërëse e dosjes së vlerësimit dhe e përdorshme vetëm në rastin e vlerësimit profesional dhe etik të tij. 3. Në çdo rast, raportet apo tërheqjet e vëmendjes, përcillen nëpërmjet zëvendëskryetarit”.

⁶⁷ Shfuqizuar neni 34, pika 2, me vendimin e KLD-së nr. 48, datë 25.4.2016 <http://arkiva.klgj.al/vendime/2016/vendim-nr-48-dat%C3%AB-25-04-2016>. Pra, kjo rregullore është shfuqizuar tërësisht për shkak të ndryshimeve kushtetuese dhe hyrjes në fuqi të ligjit nr. 115/2016, por vlen të theksohet se edhe për kohën kur ka qenë e zbatueshme pika 2 e nenit 34 është shfuqizuar me vendimin nr. 48, datë 25.4.2016, pasi është gjetur në kundërshtim me ligjin.

⁶⁸ Në këtë vendim faktet e çështjes janë të ngjashme pasi paditësit/gjyqtar shkelja e pretenduar e kryer nga ish-Inspektorati i KLD-së i është regjistruar për efekt të vlerësimit etik dhe profesional për shkak të mosshqyrtimit të kërkesës për sigurimin e padisë brenda afatit 5-ditor të parashikuar nga Kodi i Procedurës Civile.

të kësaj ankese. Subjekti ka sqaruar se mosrespektimi i afatit 5-ditor ka ardhur për shkaqe objektive dhe procedurale, konkretisht: për shkak të paaftësisë shëndetësore të gjyqtarës së çështjes; për shkak të kërkesës së vetë palës paditëse (ankuese) për të shtyrë seancën; për shkak të mungesës së provave nga ana e palës paditëse (ankuese); për shkak të lënies kohë palës paditëse për të rregulluar të metat e padisë. Gjithashtu, subjekti ka sqaruar se në caktimin e seancave vijuese me qëllim shmangien e seancave joproductive, gjykata ka marrë parasysh edhe vetë pamundësinë objektive për të qenë prezent në seancë të palëve në proces (edhe të avokates së palës paditëse), si dhe nga gjykata është marrë në konsideratë koha e nevojshme për kryerjen e njoftimeve efektive, pasi çështja kishte pasur disa palë ndërgjyqëse, disa prej të cilave e kishin adresën në qytetin e Tiranës dhe Durrësit. Subjekti ka konfirmuar se, gjithashtu, për shkak të objektit të kërkesëpadisë çdo akt apo vendimmarrje e gjykatës i njoftohet edhe Avokaturës së Shtetit dhe, për këto shkaqe, ajo ka qartësuar se ka qenë i pamundur shqyrtimi i çështjes brenda afatit 5-ditor.

39.3 Në lidhje me konstatimin e inspektorëve se gjykata duhej të vendoste për sigurimin e padisë, megjithëse vetë pala që ka kërkuar marrjen e sigurimit të padisë ka kërkuar shtyrjen e seancës, pasi nuk i dispononte provat (këto të fundit i dispononte avokatja e zgjedhur, e cila nuk ishte paraqitur në seancë gjyqësore), subjekti ka sqaruar se shqyrtimi i një kërkesë në të tilla rrethana do të ishte një cenim i së drejtës për një proces të rregullt ligjor, pasi gjykata do të merrte një vendimmarrje pa asnjë provë dhe pa dëgjuar palën që pretendon shkeljen e një të drejte. Subjekti ka sqaruar mbi kriteret e sigurimit të padisë. Ka sqaruar se shtyrja e seancave ka qenë pikërisht në funksion të respektimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor. Neni 42 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe neni 6 i KEDNJ-së prevalojnë mbi parashikimet e Kodit të Procedurës Civile (i cili në këtë rast normon shqyrtimin e një kërkesë brenda afatit 5-ditor), pasi garantojnë të drejtën për njoftimin e palëve, të drejtën për t'u dëgjuar etj. Me gjithë vështirësitë që ka pasur ky proces, ardhur këto edhe për shkak të sjelljes së palëve⁶⁹, subjekti ka sqaruar se prej saj janë kryer të gjitha veprimet e nevojshme procedurale dhe administrative për zhvillimin e gjykimit në kohë dhe duke respektuar të gjitha aspektet e procesit të rregullt ligjor, i cili nuk manifestohet vetëm në respektimin e afatit. Kohëzgjatja e gjykimit të kërkesës për sigurimin e padisë në rastin konkret duhet vlerësuar në raport me faktorët që kanë ndikuar në këtë proces, për të shmangur çështje që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit dhe që lidhen me kompleksitetin e çështjes, sjelljen e palëve, pamundësinë shëndetësore, kryerjen rregullisht të njoftimeve, dhënien mundësi palës paditëse (ankuese) për të paraqitur provat etj. Në rastin konkret, nga të gjitha procesverbalet e seancave nuk ka asnjë seancë të shtyrë pa shkak të përligjur, duke rrëzuar në këtë mënyrë konkluzionin që kanë arritur inspektorët se kjo ankesë duhet të merret në konsideratë për efekt të vlerësimit profesional, për shkak të shkeljes së afatit 5-ditor për shqyrtimin e kërkesës për sigurimin e padisë. Subjekti ka depozituar: (i) shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 19.10.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe praktikën e trajtimit të ankesës së shtetasit SH.B, bashkëlidhur; (ii) kopje vendimi nr. ***, datë 24.2.2021, të Gjykatës Administrative të Apelit; (iii) kopje vendimi nr. ***, datë 10.2.2020, të Gjykatës Administrative të Apelit; (iv) kopje vendimi nr. ***, datë 3.4.2018, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

39.4 Komisioni, pas shpjegimeve të dhëna të subjektit gjatë hetimit dhe analizimit të dokumentacionit të administruar, nuk konstatoi ndonjë problematikë të një niveli të tillë që përbën shkak për cenimin e kriterit profesional apo procesit të rivlerësimit për këtë subjekt.

⁶⁹ Vetë pala paditëse ndërkohë që kërkonte marrjen e masës së sigurimit të padisë kërkonte shtyrje të seancës, pasi nuk dispononte provat, në seancë nuk paraqitej përfaqësuesja e palës paditëse, pasi kishte procese të tjera në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, nuk plotësonte të metat e padisë lidhur me vlerësimin e objektit të padisë (vlerë që diktonte shqyrtimin e çështjes me një apo me tre gjyqtarë) etj.

40. Në lidhje me denoncimet⁷⁰ e paraqitura në Komision për subjektin e rivlerësimit, sipas nenit 53 të ligjit nr. 84/2016, ka rezultuar se është paraqitur i përsëritur vetëm denoncimi⁷¹ i shtetasës E.O.

40.1 Në denoncimin e saj, Komisioni vëren se denoncuesja pretendon se subjekti i rivlerësimit ka zhvilluar vetëm katër seanca gjyqësore dhe nuk i ka komunikuar vendimmarrjen e saj. Sipas denoncimit dhe akteve që janë bashkëlidhur, rezulton se denoncuesja, me cilësinë e motrës së dëshmorit të atdheut D.S, ankohet ndaj vendimit nr. ***, datë 28.5.2015, marrë nga Këshilli i Komunës O. i V., bazuar në ligjin nr. 8652, “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, i cili ka vendosur heqjen e emrit D.S (vëllait të saj) shkollës 9-vjeçare dhe vendosjen e emrit të mësuesit të parë të fshatit O, SH.O, si dhe në kujtim dhe nderim të dëshmorit të atdheut D.S, bërjen e një memoriali dhe vendosjen e tij në qendër të fshatit. Në denoncim thuhet se në Prokurorinë e Rrethit Dibër denoncuesja ka depozituar kallëzim penal për shpërdorim detyre, ndaj disa shtetasve me detyra zyrtare deri dhe ish-prefektin e Qarkut Dibër, çështje për të cilën Prokuroria ka vendosur disa herë pushimin dhe mosfillimin.

40.2 Sipas vendimit gjyqësor nr. ***, datë 10.6.2019 (bashkëngjitur denoncimit), duket se denoncuesja ka ankimuar vendimin e prokurorisë dhe ka kërkuar zgjidhje në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Dibër. Kjo e fundit, me vendimin e saj ka vendosur rrëzimin e padisë. Më tej, denoncuesja ka ushtruar të drejtën e ankimit. Gjithashtu, sipas parashtrimit në denoncim, thuhet se zgjidhjen e kësaj çështjeje denoncuesja e ka kërkuar edhe në rrugë administrative. Më konkretisht, ajo ka konfirmuar se Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, në gjykimin e çështjes me palë ndërgjyqëse, paditëse E. O, të paditur Këshilli i Bashkisë ***, palë të treta Bashkia ***, shkolla 9-vjeçare “****”, me objekt “Konstatimi i pavlefshmërisë absolute të aktit administrativ, vendimit nr. ***, datë 23.4.2015, të ish-Këshillit të Komunës O; Detyrimi i palës së paditur që të emërojë me emrin “D.S” institucionin arsimor shkollën 9-vjeçare “****”, me vendimin nr. ***, datë 23.12.2015”, ka vendosur rrëzimin e padisë. Ky vendim, ka sqaruar denoncuesja, ka marrë formë të prerë me vendimin nr. ***, datë 29.3.2018, të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, e cila ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

40.3 Për këtë çështje është pyetur⁷² edhe subjekti i rivlerësimit. Në përgjigjen e dhënë, subjekti sqaron se ka gjykuar çështjen dhe ka vendosur për ta çuar atë për gjykim. Për pretendimin e viktimës se nuk i është komunikuar vendimmarrja gjyqësore e dhënë prej saj, ajo ka deklaruar se është tërësisht i pabazuar, pasi jo vetëm që vendimi i seancës paraprake për pranimin e kërkesës për dërgimin e çështjes në gjyq (dhënë prej gjykatës/subjektit) është shpallur rregullisht në prani edhe të viktimës (denoncueses E.O) dhe mbrojtësit të saj ligjor, por janë respektuar të gjitha hapat procedurale sipas rritit të gjykimit të seancës paraprake.

40.4 Lidhur me kërkesën për të konfirmuar statusin aktual të çështjes, subjekti ka sqaruar se vendimi mbi pranimin e kërkesës për dërgimin e çështjes në gjyq është një vendim i paankimueshëm (konform nenit 332/gj⁷³ të Kodit të Procedurës Penale), ndërsa ndaj vendimit të themelit nr. ***, datë 10.6.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër (gjykuar nga një tjetër gjyqtar) është ushtruar ankim nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Dibër, si dhe nga shtetasja E.O, ankim i cili ende nuk është shqyrtuar nga Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.

⁷⁰ Pranë Komisionit janë paraqitur 2 denoncime në kohë të ndryshme, nga e njëjta denoncuese dhe me të njëjtin objekt ankimi.

⁷¹ Nr. *** prot., datë 13.9.2019, administruar në dosjen e Komisionit dhe nr. *** prot., datë 27.10.2022, administruar në dosjen e Komisionit.

⁷² Me pyetësin nr. 3, datë 27.9.2023, administruar në dosjen e Komisionit.

⁷³ Neni 332/gj i Kodit të Procedurës Penale: “Ankimi 1. Kundër vendimit për dërgimin e çështjes në gjyq nuk lejohet ankimi. 2. Kundër vendimit për pushimin e akuzës ose çështjes prokurori, i pandehuri dhe viktimja ose trashëgimtarët e saj mund të bëjnë ankim në Gjykatën e Apelit”.

40.5 Për sa është përshkruar më sipër, në konsideratë edhe të shpjegimeve të subjektit, Komisioni konstatoi se nuk prezantohen fakte apo rrethana, të cilat mund të ndikojnë në vlerësimin e kriterit profesional të subjektit të rivlerësimit.

40.6 Po ashtu, nga verifikimi i medias *online* nuk rezulton ndonjë e dhënë apo informacion për hetime të mëtejshme lidhur me subjektin e rivlerësimit.

40.7 Në konkluzion përfundimtar lidhur me kriterin e aftësive profesionale, Komisioni çmon se për subjektin e rivlerësimit Gilda Hoxha nuk janë konstatuar mangësi profesionale dhe, në këto kushte, referuar nenit E të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut VI të ligjit nr. 84/2016, ajo arrin nivelin kualifikues sipas neneve 44/a dhe 59/c të ligjit nr. 84/2016.

KONKLUZION PËRFUNDIMTAR

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mbledh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, referuar në nenin 4, pika 2, nenin 58, pika 1, shkronja “a”, si dhe në nenin 59, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit Gilda Hoxha:

- a. ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë;
- b. ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës;
- c. ka arritur nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në nenin 179/b të Kushtetutës, nenin D të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe në pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mbledh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Francesco Ciardi, në bazë të shkronjës “a” të pikës 1 të nenit 58 dhe të pikave 1 dhe 4 të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, znj. Gilda Hoxha, gjyqtare në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë, si dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim mund të ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga Komisioneri Publik dhe/ose subjekti i rivlerësimit 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.

4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.
Ky vendim u shpall në datën 24.11.2023.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Lulzim HAMITAJ
Kryesues

Brunilda BEKTESHI
Relatore

Etleda ÇIFTJA
Anëtare

Sekretare gjyqësore
Albana Plaka